

Analiza

Sthurja e
Bashkimit
European



Refugjatet

Nje shans
per Europen
e plakur



Ide

Kapitalizmi i
rrezikuar nga
kapitalistet

Politika

Botim elektronik i ASP ne bashkepunim me Bota.al-Shtator 2015

Lojëra

LUFTE

Cila është loja e e vërtetë Vladimir Putinit në Siri?



Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

bota.al

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

botimeshqip.com
Libri Shqip në shqipëri tani!

Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



Një prej “dënimeve” që merr kur refuzon të marrësh pjesë në politikë, është se përfundon duke u qeverisur nga ata që janë inferiorë ndaj teje.

Platoni

Vendi më i nxehtë në Ferr u është rezervuar atyre që qëndrojnë neutralë, në kohëra konflikti të madh moral.

Martin Luther King Jr.

Politika është luftë pa gjakderdhje, ndërkohë që lufta është politikë me gjakderdhje.

Mao Cedun

Njeriu është nga natyra një kafshë politike.

Aristoteli

Nëntëdhjetë përqind e politikanëve i japin dhjetë përqindëshit tjetër një reputacion të keq.

Henry A. Kissinger



Shturja e Bashkimit Evropian

NGA ROSA BALFOUR

Bruksel - Turqia, me një popullsi prej 75 milionë banorësh, ka mirëpritur deri më sot rreth 2 milionë refugjatë nga luftërat e vazhdueshme në Siri dhe Irak. Libani, me më pak se 5 milionë qytetarë, i ka hapur dyert mbi 1 milionë të tjerëve. Jordania, me një popullsi 6.4 milionë, aktualisht ka pranuar afërsisht 1 milionë banorë. Këto shifra të njohura, tregojnë se si seria e mosmarrëveshjeve mes vendimarrësve evropiane, mbi zhvendosjen e 120 mijë refugjatëve, është qesharake në përpjesëtim me problemin. Megjithatë, ajo mund edhe të përbëjë edhe një hap tjetër drejt shturrjes së Bashkimit Evropian.

Nënshkruesit e Marrëveshjes Shengen, që krijoi një zonë pa kufij nëpër shumë vende të Evropës, me siguri mund të rivendosin kufijtë kombëtarë në rrethana të jashtëzakonshme, sikurse veproi këtë javë dhe në mënyrë të njëanshme Gjermania. Kjo nuk është hera e parë që ka ndodhur.

Përveç disa episodeve të izoluara në vitet 2000, Danimarka e ndërromori këtë hap në vitin 2011, me pretendimin për të luftuar kontrabandën, dhe Franca në prag të revolucioneve të Pranverës Arabe, për të parandaluar hyrjen në vend të mbi 20 mijë tunizianëve, që do përdornin Italinë si trampolinë (ashtu si Tunizia ka mikpritur mbi 400 mijë refugjatë nga lufta në Libi).

Në fakt në vitin 2011, u fol për një krizë të Shengenit, dhe nevojën për të ndrysh-

huar rregullat. Vendet në kufijtë e BE-së, kanë bërë thirrje në mënyrë të përsëritur, për një ndarje më të drejtë të barrës së refugjatëve dhe emigrantëve. Por asgjë nuk është bërë ndonjëherë në lidhje me këtë çështje.

Shpalosja e katastrofës së refugjatëve, është simptomë e një krize të thellë evropiane. Ajo tregon sërish frakturat, që kanë dalë në sipërfaqe në mënyrë dramatike në të gjithë eurozonën. Këto thyerje nuk e kanë ndarë ende BE, por këtë verë liderët e unionit ishin shumë pranë një pike kthese, dhe nuk ka asnjë shenjë se s'do të ketë negociata të tjera të vështira, përse kohë që nuk adresohen mangësitë e thella strukturore të konvergencës ekonomike në të gjithë kontinentin.

Problemi i tanishëm duhet të ishte parashikuar. Kriza e refugjatëve, e karakterizuar gabimisht nga shumë vetë si një krizë e migracionit, nuk ka rënë vetëm mbi kryet e Evropës. Ajo është gjithashtu pasojë e dështimit të politikës së jashtme, përgjegjësi e evropianëve dhe shumë vendeve të tjera, ku inercia ndërkombëtare lejoi që kryengritja siriane e vitit 2011, të shndërrohet në një luftë civile dhe pas-taj në një konflikt rajonal të pafundëm.

Deri tani, përgjigja e Evropës ka qenë mbështetja mes shteteve, në një përpjekje për të transferuar menaxhimin e krizës së refugjatëve dhe ndihmës humanitare tek fqinjët tashmë të mbi-ngarkuar, pavarësisht nga kushtet në vendet me Sirinë fqinje. Një politikë e tillë ka të meta të mëdha.

Ajo supozon se këto vende, mund të veprojnë si zona tampon për të mbrojtur Evropën, me kufij të fortë dhe struktura të brendshme të afta për të pritur refugjatët, në respekt të plotë të së drejtës ndërkombëtare. Ndërkaq injorohet fakti se lëvizjet e popullsisë nuk mund të ndalen. (Menaxhimi i fundit i Detit Mesdhe, ka treguar se si mbyllja e një rruge, çon në hapjen e një tjetre).

Dhe kjo e bën Evropën të prekshme nga zhvillimet në vendet e treta, të cilat s'mund të jenë gjithmonë në preferencat e Evropës. Jo shumë kohë më pare, ish-udhëheqësi libian Muamar Gedafi, i mbajti evropianët nën kontroll, duke i kërcënuar se do të dërgonte më shumë emigrantë përtej detit.

Dështimet e politikës së jashtme të Evropës, nuk duhet të nënvlerësohen. Por kjo nuk është çështja e vetme, për të cilën janë të ndara shtetet anëtare. Një krizë tjetër e ka goditur Evropën në kufirin e saj lindor, me aneksimin e Krimesë nga Rusia dhe kërcënimit ndaj sovranitetit të Ukrainës. Uniteti i derisotëm për një reagim të përbashkët kundër Rusinë, mund të zhduket në rast se kryeqytetet evropiane vazhdojnë të grinden.

Më herët gjatë kësaj jave, ndalimet e udhëtimit të individëve rusë për shkak të sanksioneve, do të vazhdojnë edhe për 6 muajt e ardhshëm, por sanksionet e rënda ekonomike do të duhet të ripërtërihen në fillim të vitit 2016. Me solidaritetin evropian të dobësuar në mënyrë të konsiderueshme, dhe shtetet anëtare që zgjedhin taktika afatshkurtra, Evropa është duke e bërë veten gjithnjë e më të prekshme ndaj problemeve të shkaktuara nga jashtë.

Nëse sistemi i Shengenit vazhdon të diskutohet në këtë mënyrë, mund të fillojë të shpërbëhet si një nga arritjet më të rëndësishme të integritetit evropian. Shengeni nuk u krijua vetëm për kufijtë e jashtëm të BE-së; para së gjithash ai synonte çmontimin e barrierave brenda Evropës. Kontinenti filloi të integrohet me lëvizjen e lirë të mallrave, dhe u zgjerua më tej me atë të kapitalit, shërbimeve dhe njerëzve, duke e bërë unionin më shumë sesa thjesht një treg të vetëm.

Pak qytetarë evropianë duan një BE, në të cilën kapitali mund të qarkullojë lehtësisht, por njerëzit do të duhet të tregojnë kartat e tyre të identitetit, për të lëvizur nga një vend në tjetrin. Evropa është duke dështuar tek standardet e veta dhe detyrimet ndërkombëtare. Ka viktimat të panumërta të dështimit të Evropës, që kërkojnë përgjigje. Milionat e refugjatë që largohen nga dhuna në Lindjen e Mesme dhe në Afrikë, janë duke paguar çmimin më të lartë, por verbëria e liderëve evropianë, mund të rezultojë deri në shpërbërjen e sistemit Shengen, dhe në fraksionimin e mëtejshëm të Evropës. /“German Marshall Fund”/



Kriza e eurozonës dëshmon se s'kemi mësuar gjë nga e shkuara

NGA ASHOKA MODY

Me një normë anormale kursimi, spiralen në ngjitje të borxhit dhe deflacionit, dhe një ekonomi të dobët globale, prej nga duhet të vijnë stimujt për rimëkëmbjen e ekonomise greke?

Në nëntor të vitit 2003, ish-ministri gjerman i Financave, Hans Eichel, shpjegoi se pse “marrëveshja” mes Greqisë dhe kreditorëve të saj, ishte thujse e sigurtë se do të dështonte. Duke i dredhuar presioneve të atëhershme mbi Gjermaninë, për më shumë masa shtrënguese fiskale në periudhën e një rënieje ekonomike, Eichel shkroi në një editorial për “Financial Times”: “Një politikë e përshtatur vetëm ndaj arritjes së objektivave të konsolidimit sasior në një periudhë afatshkurtër, rrezikon jo vetëm frenimin e rritjes ekonomike, por edhe shtimin e borxhit”. Teorema e Eichel, thotë se qeveria e fundit greke, edhe nëse do të jenë të qëndrueshme, s’do të arrijë të kapërcejnë logjikën e programit të kreditorëve. Rritja ekonomike, do të jetë më e ngadaltë dhe deflacioni më i fortë sesa ishte parashikuar.

Barra e borxhit do të vazhdojë të rritet.

Teorema e Eichel, është dëshmuar qëndrueshmërisht magjepsëse gjatë Recesioni të Madh: masat shtrënguese këmbëngulëse janë kundërproduktive, sa më shumë që ekonomia është e dobët. Kudo, masat shtrënguese vetëm sa e kanë reduktuar rritjen ekonomike. Greqia, vendi që ka ndërmarrë masat më të ashpra të kursimit, ka përjetuar edhe tkurrjen më të thellë ekonomike. Edhe një dritëz e vogël në fund të tunelit, përmes rritjes së parë ekonomike greke në vitin 2014, erdhi gjatë një pauze të masave të kursimit.

Sipas shumë vlerësimeve, Greqia po përjeton një defiçit të vogël fiskal primar: shpenzimet qeveritare (pa llogaritur pagesat e interesit) i tejkalojnë faturat. Arritja e objektivit kryesor të kreditorëve, që është një sufiçit prej 3.5 përqind të PBB-së në 3 vitet e ardhshme, do të shkatojë me siguri tkurrjen e mëtejshme të ekonomisë.

Por hartuesit e marrëveshjes, pretendojnë se ekonomia greke do të rinisë të rritet. Ata kanë një përbuzje të thellë ndaj marrëdhënieve ekonomike.

Në vitin 1933, ekonomisti Irving Fisher shpjegoi se kur nivelet e borxhit janë të larta, shlyerja e borxhit e rrit barrën e tij. Në përpjekje për të shlyer borxhin, konsumi dhe investimet bien, dhe kjo nga ana tjetër shkakton uljen e çmimeve dhe pagave. Por për shkak se detyrimet e borxhit nuk ulen, edhe barra e shlyerjes së tij rritet.

Greqia ka qenë në një cikël të borxh-deflacionit, gjatë 2 viteve të fundit. Çmimet dhe pagat në vend janë në rënie, dhe ndërkohë që kjo mund të ndihmojë ekonominë në një periudhë afatgjatë – tani për tani, borxhi në raport me të ardhurat po rritet. Masat shtrënguese shtesë, do ta përforcojnë këtë prirje. Megjithatë, parashikimet supozojnë se çmimet do të rriten dhe ndihmojnë në uljen e barrës së borxhit privat dhe publik. Në fakt do të bëhet më keq. Kur, në vitin 2003, Gjermania u çlirua nga “pranngat” e kursimit fiskal, dhe tregtia botërore pësoi një rritje të ndjeshme. Për katër vjet, në 2004-2007, rritja e tregtisë botërore ishte mesatarisht 9 përqind në vit.

Pretendimi për një “mrekulli” gjermane, është i bazuar në dy vitet e rritjes vjetore në nivelin 3.5 përqind në vitet 2006-2007, mes asaj ekonomie të gjallë botërore. Greqia po hyn aktualisht në një raund tjetër të masave shtrënguese, me rritjen e tregtisë botërore nën 3 përqind në vit. Me vendimin e saj për të mos rritur normat e interesit javën e kaluar, Rezerva Federale e SHBA-së dëshmoi se sa e brishtë mbetet ekonomia globale. FMN-ja ka ulur plot 3 herë që nga fillimi i vitit, parashikimet e saj për rritjen e PBB-së botërore dhe tregtisë.

Me një normë anormale kursimi, spiralen në ngjitje të borxhit dhe deflacionit, dhe një ekonomie të dobët globale, prej nga duhet të vijnë stimujt për rimëkëmbjen e ekonomise greke? Thuhet se magjia qëndron tek në eliksiri i reformave strukturore. Mundet të jetë e vërtetë, por të mos gabojmë: nuk ka asnjë dëshmi se reformat strukturore e nxisin forcën dhe shpejtësinë e supozuar përse i përket parashikimeve për ekonominë greke. Eurozona ka jetuar përmes miteve ekonomike

Pretendimi për një “mrekulli” gjermane, është i bazuar në dy vitet e rritjes vjetore në nivelin 3.5 përqind në vitet 2006-2007, mes asaj ekonomie të gjallë botërore. Greqia po hyn aktualisht në një raund tjetër të masave shtrënguese, me rritjen e tregtisë botërore nën 3 përqind në vit. Me vendimin e saj për të mos rritur normat e interesit javën e kaluar, Rezerva Federale e SHBA-së dëshmoi se sa e brishtë mbetet ekonomia globale. FMN-ja ka ulur plot 3 herë që nga fillimi i vitit, parashikimet e saj për rritjen e PBB-së botërore dhe tregtisë.

të njëpsnjëshme, së pari virtytet e një monedhe të përbashkët për vendet e ndryshme evropiane, më pas fuqitë shëlbuese të kursimit fiskal, dhe tashmë reformat strukturore që shihen si zgjidhjet e të gjitha sëmundjeve ekonomike.

Këto mite mbështeten nga një grup mendimtarësh në mesin e “elitave” evropiane, që mbrojnë njëri tjetrin duke mbështetur idetë e veta. Kur në vitin 2003, Gjermania detyroi anëtarët e tjerë të zonës euro që të pezullonin rregullat fiskale, që do të kishin turpëruar një Gjermani luftarake, kancelari Gerhard Schröder në mënyrë cinike, por të saktë, e quajti atë një vendim të “mençur”.

Por një presion i tillë, është në përputhje me normat e grupit ndaj të cilit Schröderi dikur kërkoi ndjesë, për thyerjen e rregullave të paarsyeshme. Një tjetër i “konvertuar” është ish kryeekonomisti i FMN-së, Olivier Blanchard. Pasi e fituar betejën intelektuale mbi kostot e masave kursimit, ai u largua nga gjetjet e tij kërkimore dhe në vend të kësaj, bëri apel për më shumë reforma strukturore në Greqi.

“Marrëveshja” vetëm sa shtyu pyetjet e vështira. Për Gjermaninë dhe kreditorët e tjerë, lehtësimi i borxheve krijon rreziqe të patolerueshme. Por, për Greqinë, fitimi i lehtësimit të borxheve s’mund të jetë thjesht çmimi, për më shumë masa shtrënguese kundërproduktive. Lehtësimi i borxheve ishte i nevojshëm që në fillim për të ulur tepricën primare në 0.5 përqind të PBB-së.

Nëse në fund të fundit Greqia do detyrohet të largohet nga zona e euros, kreditorët do të pësojnë humbjet më të mëdha, nëse ata do të ofrojnë aktualisht lehtësimin e borxhit. Dhe Grexit në mënyrë të pakthyeshme do të shpërbëjë unionin tanimë të fragmentarizuar. Mësimet që nuk janë nxënë, duhen rilexuar. Grekët do të durojnë edhe më shumë dhimbje, kreditorët do të shohim pak nga paratë e tyre. Kjo në fund të fundit është tragjedia greke. /“Bruegel”



Ja 12 njerëzit që e shkatërrojnë Shengenin

Nga Bush tek El-Bagdadi, nga Obama tek Orban, këta janë burrat që qëndrojnë prapa kaosit me emigrantët

NGA MICHAEL BINYON

Fillimi i kontrolleve të rrepta në kufi nga ana e Gjermanisë, për të frenuar fluksin e madh të refugjatëve dhe emigrantëve, duket si një goditje vdekjeprurëse ndaj marrëveshjes së Shengenit dhe lëvizjes së lirë të njerëzve, përmes së cilës 26 vende evropiane patën hequr kontrollet e brendshme të pasaportave. Por nuk është kancelarja Angela Merkel, ajo që e ka shkatërruar Shengenin - ajo ende këmbëngul se masat janë të përkohshme.

Përkundrazi, janë nacionalistët, diktatorët, kriminelët dhe trafikantët e qenieve njerëzore jashtë Evropës, ata që po minojnë këtë moment të rrallë të procesit të integritimit. Gjithashtu edhe disa politikanë të njohur, kanë përgjegjësi të mëdha mbi këtë çështje, qoftë nga padituria, mospërfillja apo qëllimi i keq. Këtu po paraqesim “Duzinën e Pistë”:

Bashar Al-Asad

Lufta brutale civile që nisi diktatori sirian, ka vrarë më shumë se 200 mijë njerëz dhe ka prodhuar 9 milionë sirianë të pastrehë, 3 milionë prej të cilëve janë larguar jashtë vendit - kryesisht në Turqi, Liban dhe Jordani. Mizoritë e shkaktuara nga forcat qeveritare, dëshpërimi dhe vuajtjet e civilëve, shkatërrimi fizik i vendit, dhe gjasat e vazhdimit të luftës edhe për vite të tjera, ka nxitur gjithnjë e më shumë refugjatë të kërkojnë strehim në Evropë. Sirianët përbëjnë pjesën më të madhe të atyre, që tani janë duke u trafikuar përgjatë Mesdheut, dhe mbyten jo rrallë përgjatë kufijve të Evropës.

Viktor Orban

Kryeministri konservator hungarez i vijës së ashpër, e ka kundërshtuar atë që ai

e quan “politikë të gabuar të emigracionit” të BE-së, dhe ka tmerruar refugjatët myslimanë, duke thënë se është duke mbrojtur natyrën e krishterë të Evropës, kundër një fluksi myslimanësh. Një politikan rebel, politikat nacionaliste dhe politikat autoritare të të cilit kanë provokuar kundërshtimin e ashpër në Bruksel, ai ka ngritur “temperature” mbi emigrantët, duke ndërtuar një gardh me tela me gjemba me Serbinë dhe dëbuar emigrantët nga trenat, duke prodhuar fotografi shqetësuese konfrontimesh. Duke insistuar se emigrantët janë një problem gjerman dhe jo evropian, ai e ka dobësuar edhe më tej aftësinë e Evropës, për të gjetur një zgjidhje të përbashkët.

Rexhep Tajip Erdogan

Një islamik ambicioz dhe autokrat, presidenti turk Erdogan ka rifilluar përplasjen ushtarake me kurdët, një veprim që shihet si një apel për mbështetjen e nacionalistëve, në prag të zgjedhjeve të reja parlamentare që janë parashikuar të mbahen në 1 nëntor. Dhuna e ripërtërirë ka nxitur mijëra kurdë të largohen nga vendi, shumica drejt Greqisë. Turqia ka bërë pak përpjekje për të ruajtur kufijtë e saj me Greqinë, apo të ndalojë valën e refugjatëve që kontrabandohen me anije në ishujt grekë. Zemërimi ndaj politikës së kufizimit të vizave që BE-ja ka ndaj Turqinë, dhe përpjekjet për të ndaluar pakësimin e mbështetjes popullore për partinë e tij AKP, mund të qëndrojnë prapa marrëdhënieve të acaruar mes tij me Brukselit.

Xhorxh W. Bush

Pushtimi i Irakut në vitin 2003, dhe politikat e dorës së hekurt që pasuan, e radikalizuan kombin që u shpartallua, duke nxitur tensionet sektare, dhënë jetë lëvizjet xhihadiste anti-perëndimore dhe përfundimisht forcuar të ashtuquajturin Shtet Islamik. Fragmentimi i Irakut, cikli i hakmarrjes mes sunitëve dhe shiitëve, si dhe shpërthimi i dhunës terroriste në Siri dhe Levant, e kanë rritur jashtëzakonisht numrin e refugjatëve që largohen për në Perëndim. Ish-Presidenti amerikan Bush, ndan përgjegjësinë për destabilizimin politik të të gjithë rajonit.

Barak Obama

Dështimi i Uashingtonit, për të patur një qëndrim të hershëm dhe të ashpër ndaj Sirisë, apo për të armatosur rebelët e moderuar, i çeli udhën ISIS-it dhe ekstremizmit të dhunshëm islamik. ISIS-i tashmë po kërcënon drejtpërdrejt Evropën, me operacionet e “ujkut të vetmuar” xhihadist, të frymëzuar nga ISIS-i dhe radikalët islamikë. Zyrtarët e sigurisë evropiane, janë paralajmëruar mbi një numër të madh xhihadistësh të lindur dhe rritur në Perëndim, që kthehen në Evropë pas trajnimit dhe luftimit në Siri, ndërsa po bëjnë thirrje për kontrollë më të ashpra mbi emigracionin– diçka kjo jo e lehtë për t’u zbatuar në një Evropë pa kufij.

Dejvid Kameron

Veçimi i Britanisë nga marrëveshja e Shengenit e vitit 1985, është përdorur nga Londra për të shmangur pjesëmarrjen në ndonjë veprim të përbashkët të BE-së, për pranimin e emigrantëve ose për të mos pranuar përgjegjësi për ata që përpiqen të hyjnë në Britani. Anijet britanike kanë shpëtuar anije të vogla që po mbyteshin në Mesdhe, por kanë refuzuar të pranojnë përgjegjësinë për ata që u kapën. Emigrantët që synojnë Britaninë, kanë qenë në gjendje të përdori portin detar të Kale-së në Francë, ndërsa kaosi që rezulton në qytetin- port, ka zemëruar Francën dhe shkaktuar thirrje për kufizimin e ndalimit të emigrantëve, që kalojnë Evropën duke përfunduar deri në Kale.

Trafikantët e njerëzve

Udhëheqësit e bandave, zakonisht nga Libia, Lindja e Mesme apo Afrika, të cilët e kanë shfrytëzuar dëshpërimin e refugjatëve dhe emigrantëve për të arritur Evropën. Taktikat e tyre brutale, shantazhi, zhvatja dhe egërsia, kanë tronditur opinionin publik evropian, teksa gjithnjë e më shumë viktimat janë mbytur në Mesdhe ose në kamionë të mbyllur. Votuesit evropianë, kanë kërkuar veprime më të ashpra për të goditur këto banda, dhe parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, dhe shumë evropianë kanë bërë ndërkohë thirrje për kontrollë kufitare, në mëny-

rë që trafikantët të mos jenë në gjendje të përfitojnë nga mungesa e kontrolleve dhe inspektimeve të policisë.

Marin Lë Pen

Si udhëheqëse e partisë franceze Frontit Kombëtar, Lë Pen është një nga drejtueset politike më të zëshme në Evropë, që kërkon rikthimin e kontrolleve kufitare, si mënyra e duhur për të trajtuar krizën e emigracionit. Vitin e shkuar, ajo vizitoi kampet e ngritura nga emigrantët në Kale, duke këmbëngulur se ishte “koha për luftë” kundër lirisë për të hyrë Francë, në mënyrë të pakontrolluar. Partia e saj anti-emigracion doli e para në zgjedhjet evropiane, duke bërë që partitë e tjera franceze dhe politikanët, t’i bëjnë jehonë çështjeve që ajo ngre për të bindur zgjedhësit. Akuza e saj se kancelarja gjermane Angela Merkel e kishte përdorur emigracionin masiv si një burim të punës së skllëvërve e zemëroi Gjermaninë, por ndikoi edhe në mendimin politik atje.

Ajub El-Kazani

Përpyekja e tij për të vrarë pasagjerët në një tren të linjës Amsterdam-Paris në muajin gusht, dështoi falë ndërhyrjes së disa pasagjerëve amerikanë dhe britanikë. Por shumë pikëpyetje u ngritën menjëherë pas kësaj ngjarje, se pse ai që në gjendje të kalonte kufirin nga Belgjika duke patur armë me vete, ndonëse lidhet e tij me islamin radikal, ishin të njohura nga forcat e sigurisë. Një histori e trafikut droge, dhe lehtësia me të cilën ai kishte lëvizur nga Spanja për në Francë dhe pastaj Belgjikë, si dhe vizita e tij në Turqi, nxitën akuzat se forcat e sigurisë në Evropë, nuk po i shkëmbejnë si duhet informacionet e shërbimeve inteligjente, për të nxjerr në pah terrorizmin ndërkuftar.

Mehdi Nemush

Në maj të vitit 2014, ai hapi zjarr në Muzeun Hebre në Bruksel, duke vrarë 4 persona. Ai ishte në gjendje të largohej për në Francë, për shkak se nuk pati kontrolle në kufirin belg. Nemush u arrestua më vonë në Marsejë. Ai dyshohet se ka luftuar për Shtetin Islamik në Siri, dhe ishte një nga vullnetarët e parë evropianë që u rikthye për të kryer sulme në Evropë. Grupet hebraike, bënë thirrje për një bashkërendim më të madh midis agjencive të inteligjencës evropiane, dhe një task forcë pan- evropiane për t’iu kundërvënë anti-semitizmit.

Isaia Afeuerki

Një autoritar, i cili ka refuzuar vazhdimisht të mbajë zgjedhje, presidenti i regjimit gjithnjë e më diktatorial të Eritresë, që ka shtyrë shumë të rinj eritreas të largohen jashtë vendit, duke rrezikuar të burgosen apo qëllohen për kalimin e paligjshëm të kufirit. Varfëria, persekutimi politik, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe rekrutimi i të rinjve për periudha të pakufizuara për përdorimin si skllavë virtualë pune, i ka bërë eritreasit ndër më të dëshpëruarit në Afrikë për të arritur Evropën. “Amnesty International”, pretendon se Afeuerki ka burgosur të paktën 10.000 vetë për arsye politike, në një kohë që tortura është një praktikë shumë e përhapur.

Ebu Bekr El-Baghdadi

I vetëshpalluri Kalif i Shtetit Islamik të Irakut dhe Sirisë, dhe ish-lideri i Al-Kaedës në Irak, regjimi i tij i pa kompromistë terrorist në lindje të Sirisë dhe perëndim të Irakut, ka vrarë mijëra njerëz nga pakicat fetare, myslimanë të moderuar dhe kundërshtarë politikë, ndërsa mesazhe të sofistikuar xhihadiste në internet, kanë joshur mijëra myslimanëve të huaj për të luftuar në Siri, të pakontrolluar në çdo lloj kufiri të brendshëm të BE-së. Terrori i përhapur nga mbështetësit e tij, është forca kryesore lëvizëse e shumë refugjatëve, që largohen nga rajoni i Lindjes së Mesme dhe kërkojnë strehim në Evropë.

Shënim: Michael Binyon është një analist i punëve të jashtme dhe ish redaktor diplomatik i “The Times” në Londër.

“Polico.Eu”



Nga Korsika në Bavari, Europa po ndahet në “mëmëdhetë” e vegjël

Të shumtë janë “mëmëdhetë e vegjël” në Europë, aq sa janë të shumta lëvizjet independentiste, separatiste, federaliste dhe autonomiste në të gjithë Kontinentin e Vjetër. Shkohet nga ata që, në të kaluarën, nuk kanë hezitur që të rrëmbejnë pushkën, si irlandezët e veriut, baskët, tirolezët e jugut, e deri tek ata që pretendojnë të drejtën e rikthimit të një identiteti kulturor të humbur, si banorët e Provenzës dhe jugut të Francës. Jashtë prej shtëpisë së përbashkët europiane, independentizmi është ende i larë me gjak, si e tregojnë luftërat në Ukrainë, pushtimi i Krimesë apo masakrat në Ish Jugosllavi. Megjithatë, nën qiellin me dymbëdhjetë yje të BE-së, pretendimet për pavarësi kanë prirjen që të kanalizohen në procese demokratike.

Europa ka patur një rol në favorizimin e dialogut, nga Ulsteri në Alto Adige, tek independentizmi bask, apo duke lehtësuar procese federalizimi, si në Belgjikë. Por rritja e pushtetit të Brukselit, në dëm të shteteve-kombe, ka favorizuar përhapjen e pretendimeve autonomiste. Nuk është rastësi që, nga Katalonja, deri në Skoci dhe në Fjandra, rajonet që kanë ambicie për t’u shkëputur nga shteti komb ku janë ndërfutur, dëshirojnë që gjithësesi të qëndrojnë në Europë.

Ideja e një “Europe të rajoneve”, e cila do të zëvendësonte gradualisht “Europën e shteteve”, ka qenë një prej themeleve të mendimit të etërve themelues. Më pas, këta janë përshtatur duke legjitimuar projektin european nga shtetet kombe, por gjithmonë me shpresën që integrimi do të sillte eliminimin e tyre si dhe do të

afirmonte një komunitet të popujve dhe të autonomive.

Nuk është rastësi që këtë herë, Presidenti i Komisionit, Jean Claude Juncker, përballë zgjedhjeve në Katalonjë ka shmangur marrjen e një qëndrimi të palëkundur, gjë që e bënte gjithmonë paraardhësi i tij. Barroso, në rastin e referendimit skocez, kërcënoi zgjedhësit se do të mbante jashtë Bashkimit Europian, një Skoci të pavarur. Junckeri, në këtë rast, ka një qasje shumë më të matur. Mes ekspertëve të çështjeve europiane, ka nga ata që këmbëngulin se Traktatet u kanë dhënë të gjithë popujve të BE-së, statusin e qytetarëve europianë. Dhe që kjo gjë, nëse nuk ka një refuzim eksplisit, qëndron edhe në rast të një përkatësie kombëtare të re. Ja një listë, shtet pas shteti, që gjithësesi mund të mos jetë tërësisht e plotë.

BRITANIA E MADHE

SKOCIA. Indipendentistët skocezë të Partisë Kombëtare Skoceze janë më agresivët dhe zotërojnë një shumicë në parlamentin e vendit. Pas humbjes në referendum, udhëheqësi i tyre, Nicola Sturgeon, nuk ka hequr dorë nga projekti i ndarjes. Një shkëputje e Katalonjës nga Spanja, apo një votim i Britanisë për të dalë nga BE, do ta rihapte çështjen.

UELLSI. Indipendentistët janë pjesë e partisë Plaid. Janë më të paktë dhe më pak radikalë se sa në Skoci. Por nëse Edinburgu do të shkëputej nga Mbretëria e Bashkuar, edhe Kardifi do të tundohet.

Kornuelli. Partia indipendentiste, Mebyon Kernou i bën jehonë rrënjëve kelte të rajonit. Por fenomeni ka më shumë karakterin e një pretendimi kulturor, se sa politik.

SPANJE

Katalanasit janë rajoni më i përparuar në rrugën drejt pavarësisë. Por po kaq përcaktues janë baskët, pretendimet e të cilëve dëmtohen prej krimeve që kanë kryer në të kaluarën terroristët e ETA-s. Lëvizje për pavarësi janë aktive edhe në Galici dhe Aragonë.

FRANCA

Kombi që ka shpikur shtetin unitar dhe e ka imponuar atë nëpër shekuj, është i prekur nga lëvizje të shumta për pavarësi. Më përcaktueset janë korsikanët, që megjithatë kanë humbur një referendum në vitin 2003. Indipendentistët janë të pranishëm në Bretanjë, Alasë dhe në Francën e jugut, ku pretendojnë autonominë.

BELGJIKA

Indipendentistët flamingë të N-VA janë parti e shumicës në veri të vendit. Ndryshe nga e djathta ekstreme e Vlaams Blok, janë floeuropeanë të bindur. Nën shtytjen e autonomizmit flaming, Belgjika u transformua nga shtet unitar, në monarki federale dhe në fund, në shtet federal.

GJERMANIA

Gjermania është një shtet federal, me hapësirë të madhe autonomie për Lander-ët e shumtë. Kjo gjë ka zbutur shtytjet indipendentiste. Megjithatë, në Bavari ekziston një parti e vogël, Bayern Partei, e cila që nga viti 1946 kërkon pavarësinë dhe që ka një shumicë katolike, si dhe një traditë të lashtë sovraniteti.

POLONIA

Edhe në Silezi ekziston një parti autonomiste më shumë se sa indipendentiste, e cila ka mbledhur pothuajse 9 përqind të votave në rajon. Silezia, e aneksuar nga Polonia pas luftës, kish qenë pjesë e Gjermanisë dhe ndikimi gjerman ndihet ende shumë, pavarësisht spastrimit etnik që detyroi miliona gjermanë të largoheshin nga tokat e tyre menjëherë pas luftës.

FINLANDA

Ishujt Aaland, nën sovranitetin finlandez, banohet nga një popullsi që flet gjuhën suedeze. Kanë siguruar një status autonomie që në vitin 1991. Por gjithmonë banorët kanë kultivuar ëndrrën e një pavarësie të plotë, qoftë edhe nën ombrellën europiane.



Një shans për Evropën e mplakur

NGA CHRISTIAN BODEWIG

Evropa po përballet me fluksin më të madh të emigrantëve ndër dekada. Numri i refugjatëve nga zonat e konfliktit në Siri, Irak, dhe vendet e tjera që mbërrijnë në brigjet jugore të Evropës, është në rritje nga dita në ditë. Shtimi dramatik i kërkesave për azil në vendet e Bashkimit Evropian, ka nxjerrë në pah ndarjet mes shteteve anëtare të BE, mbi atë se si duhet të reagojnë.

Qeveritë në Evropën Qëndrore dhe vendet Baltike, kanë hedhur poshtë propozimet e bëra nga Komisioni Evropian, për të përdorur kuotat e detyrueshme për të shpërndarë refugjatët nëpër 28 shtetet anëtare, duke dalë kundër pranimin të një numri të madh refugjatësh.

Por prisni një moment. Kundërshtia ndaj emigracionit duket kundërintuitive, për vendet që përballen me perspektivën e mplakjes dhe zvogëlimit të shpejtë të popullsisë. Për shembull, vendet baltike dhe Bullgaria kanë parë tashmë popullatat e tyre të tkurren me më shumë se 15 përqind që nga viti 1990, Kroacia me 10 përqind, dhe Rumania dhe Hungaria me më shumë se 5 përqind.

Pjesa e popullsisë e moshës 65 e sipër, në vendet e Evropës Qendrore, si dhe në vendet Baltike është rritur me më shumë se një të tretën ndërmjet viteve 1990-2010. Në dallim nga Evropa Perëndimore, ku njerëzit jetojnë më gjatë, mplak-

ja në Evropën Qendrore dhe vendet balltike është nxitur nga emigrimi masiv, veçanërisht i të rinjve që shpesh shkojnë në Evropën Perëndimore, por edhe për shkak të rënies së konsiderueshme të normës së fertilitetit.

Kjo normë në Evropën Qendrore dhe vendet baltike, sot është mesatarisht nën 1.6. Kjo shifër është edhe më e ulët në Poloni, Hungari, Sllovaki me 1.3, pra shumë larg normës 2.1, që garanton rritjen e popullsisë. Studimet sugjerojnë se mplakja dhe rënia demografike, do të vazhdojnë dhe madje edhe përshpejtohen në të ardhmen, duke vënë në rrezik rritjen ekonomike dhe duke shtuar presionet fiskale, përmes mbështetjes më të madhe për pensionet e pleqërisë dhe shërbimet shëndetësore.

Si mund ta përballojë Evropa këtë sfidë? Vendet mund të minimizojnë pasojat ekonomike dhe sociale të ndryshimeve demografike, përmes politikave që i bëjnë krahun e vogël të punës më produktiv, duke përfshirë edhe përmirësimet në aftësitë dhe shëndetin e punonjësve, në mënyrë që ata mund të jenë të punësuar më produktive dhe me jetë më të gjatë.

Duke pasur parasysh numrin e madh të emigrantëve nga vendet e Evropës Qendrore dhe ato Balltike gjatë dy dekadave të fundit, emigracioni nuk do të shkaktojë rënien e popullsisë në moshë pune. Përkundrazi, me numrat e refugjatëve në Evropë që po shtohen përditë e më tepër, emigracioni gradualisht do të bëhet një element i përgjigjes së politikës. Çështja reale e politikës për vendet e Evropës Qendrore dhe në vendet Baltike sot, nuk është nëse do të pranojë apo jo emigrantët, por përkundrazi, sesi ta kthejë sfidën e krizës së sotme të refugjatëve në një shans.

Së paku, shembujt e Turqisë dhe Jordanisë, tregojnë se mikëpritja e numri shumë më të madh refugjatësh sesa Evropa, s' duhet të jetë një barrë ekonomike. Duke patur parasysh kushtet e tmerrshme dhe të vështira në vendet e tyre të origjinës, refugjatët nga Siria, Iraku, dhe Eritrea që vijnë sot në Evropë, ka të ngjarë të qëndrojnë për një farë kohe.

Kjo sugjeron se pasi të përmbushen nevojat emergjente humanitare afatshkurtra, ata do të kërkojnë strehim të qëndrueshëm, shkollim, shërbim shëndetësor dhe më pas një punë për një periudhë afatmesme. Për shembull, përderisa një numër i madh refugjatësh po vijnë me fëmijët në moshë shkollore, shkollat kanë nevojë për kapacitete për klasat parapërgatitore për t'i mundësuar fëmijëve të mësojnë gjuhën e vendit pritës, dhe për t'u integruar në klasa të përgjithshme.

Sistemet e arsimit në vendet e Evropës Qendrore dhe ato Balltike, janë përshtatur me rënien e numrit të studentëve, kështu që duhet të ketë një infrastrukturë dhe kapacitet të mjaftueshëm mësuesish për të akomoduar fëmijët refugjatë dhe të rinjtë. Shumë emigrantë që mbërrijnë aktualisht në Evropë, kanë aftësitë dhe motivimin për të qenë të suksesshëm, dhe për të dhënë kontributin e tyre për ekonominë e vendeve mikëpritëse.

Shumë prej refugjatëve vijnë së bashku me fëmijët. Ata kanë potencial jo vetëm për të zvogëluar rënien e numrit të punëtorëve, por edhe për të nxitur risi, përmes sjellës së ideve dhe perspektivave të freskëta. Integrimi i emigrantë përbën një sfidë. Unë mund të përmend shumë shembuj në të gjithë Evropën, ku integrimi nuk ka qenë i suksesshëm. Por ka edhe të tjerë.

Merrni shembullin e komunitetit vietnamez, që ka jetuar në Republikën Çeke për dekada të tëra. Sot atje jetojnë më shumë se 60 mijë vietnamezë – 20 herë më shumë sesa kuota e refugjatëve që Komisioni Evropian ka përcaktuar për këtë vend. Shumë vietnamezë kanë shkëlqyer në arsim dhe janë aktive në komunitetin e biznesit. Shembuj si të dështimit dhe suksesit sa i përket integrimin, janë mësim për të informuar politikën, sesi reagimi i Evropës ndaj krizës së refugjatëve, të jetë jo vetëm një akt thelbësisht humanitar, por edhe një investim i zgjuar për zhvillimin e saj ekonomik.

“Brookings Institute”



A është Turqia pranë luftës civile?

Nga Kemal Kirishçi dhe Sinan Ekim

Politika turke po rrëshqet thellë e më thellë në një gjendje kaosi, me implikime të rëndësishme për politikën amerikane në Lindjen e Mesme, dhe veçanërisht në Siri. Në dy javët e fundit, nuk ka patur një ditë të vetme pa atentate, ku kanë mbetur të vrarë ushtarë dhe punonjës policie nga Partia Punëtorëve e Kurdistanit (PKK), civilë të bllokuar në qytetet nën shtetrrëhim, dhe Forcat Ajrore turke që bombardojnë zonat e kontrolluara nga kurdët. Që prej shpërthimit vetëvrasës në Suruç në 20 korrik, ka pasur të paktën 132 të vdekte të dokumentuara të personelit turk të sigurisë dhe qindra luftëtarë të PKK-së e civilë të kapur në kryqëzimin e shkëmbimit të zjarrit. Përleshjet midis forcave të sigurisë dhe të rinjve të militarizuar në qytetet kurde, janë gjithashtu të zakonshme, njëlloj si përpjekjet e fundit për të garantuar zonat të vetë-shpallura si autonome nga PKK. Mediat janë të mbushura me pamjet e llogoreve dhe barrikadave, të gërmuara nga luftëtarët kurde për të bllokuar forcat e sigurisë. Në shenjë hakmarrjeje, turma anti-kurde kanë sulmuar bizneset në pronësi të kurdëve si dhe zyrat e Partisë

Demokratike Popullore Kurde (HDP) në mbarë vendin.

Ekzistojnë shqetësime në rritje, se kjo spirale dhune mund të dalë jashtë kontrollit, madje të arrijë deri aty sa të provokojë një luftë civile ndërmjet kurdëve dhe turqve, të një lloji që vendi nuk ka e përjetuar më parë. Nëse kjo situatë vazhdon e tillë ose përkeqësohet më tej, Shtetet e Bashkuara rrezikojnë të humbasin një shtyllë të stabilitetit, në një rajon përherë të trazuar.

Pas shumë vitesh qetësie relative, e shoqëruar me pritshmëritë e rastit, për një zgjidhje politike të problemit kurd në Turqi, çfarë po e nxit aktualisht këtë shpërtëhim të papritur të dhunës? A mos ndoshta ethet e zgjedhjeve të reja parlamentare të 1 nëntorit, kanë përfshirë edhe presidentin turk Rexhep Taip Erdogan? Dështimi zgjedhor

Ky përshkallëzim i dhunës është duke u nxitur nga një mori ngjarjesh. Më kryesorja është rezultati i paqartë i zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura në fillim të qershorit të këtij viti. Partia për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP) në pushtet, e mbështetur energjikisht nga presidenti Rexhep Taip Erdogan, nuk arriti të marrë numrin e nevojshëm të vendeve në parlament, për të formuar një qeveri më vete.

Kjo dëmtoi planet vetjake të Erdoganit, të strukturuar rreth AKP-së për marrjen e vendeve të mjaftueshme për miratimin e një kushtetutë të re, që do t'i jepte atij fuqi më të mëdha ekzekutive. Ironikisht, Erdogan pati bërë thirrje edhe për zgjidhjen e problemit kurd në Turqi - një lëvizje kjo taktike për të gjeneruar kapital politik në mesin e elektoratit kurd. Ishte administrata e AKP-se, ajo që kishte zbatuar një seri reformash, në mbështetje të drejtave kulturore kurde përgjatë viteve 2000, dhe ishte Erdogan ai që nisi një dialog me liderin e burgosur të PKK-së Abdullah Oçalan në vitin 2012. Këto përpjekje dhanë frytet e tyre: Në vitin 2007 dhe në zgjedhjet e përgjithshme të 2011-s, AKP-ja fitoi 26 nga 38 vendet e mundshme në Agri, Bitlis, Diyarbakir, Hakari, Mardin, Sirnak, dhe Van - krahinat e populluara kryesisht nga kurdët.

Kurdët shkojnë në Ankara

Shumë ngjyra janë venitur që nga ajo tablo rozë. Kur Shteti Islamik, e rrethoi qytetin kurd të Kobanit në kufirin siriano-turk në tetor të vitit 2014, qeveria turke hezitoi të mbështeste kurdët. Kjo, së bashku me akuzat se Turqia ishte në fakt mbështetëse e ISIS-it, për të parandaluar kurdët nga konsolidimi i kontrollit në territoret e tyre në veri të Sirisë, nxiti pakënaqësi të mëdha në mesin e komunitetit kurd.

Goditja vendimtare erdhi kur Erdogani la të kuptohej, se mbrojtja e Kobanit ishte diçka e parëndësishme. Ai shkoi më tej, duke u shprehur troç se ishte çështje kohe, që ai qytet të binte në duart e ISIS-it. Kundër sfondit të zhdukjes Kobanit dhe largimit të më shumë se 200 mijë kurdëve sirianë drejt Turqisë, besimi mes qeverisë turke dhe kurdëve në përgjithësi u zhduk plotësisht.

Ndërkohë në kundërshtim me parashikimin e Erdoganit, ndihma nga kurdët e Turqisë dhe Irakut, si dhe nga Shtetet e Bashkuara, e shpëtoi Kobanin nga ISIS-i. E gjitha kjo e motivoi Partia Demokratike të Popullit (HDP), që të konkurronte në zgjedhjet e qershorit si një parti politike.

Deri atëhere të kujdesshme dhe të frikësuar nga pragu tejet i lartë zgjedhor Turqisë prej 10 përqind për të hyrë në parlament, politikanët kurdë kishin garuar më herët në zgjedhje si të pavarur. Lideri karizmatik i HDP-së, Selahatin Demirtash, përfitoi me me sukses nga mosbesimi i thellë, që kishte filluar të ndjehej ndaj Erdoganit, duke fituar mbështetjen e konservatore kurdë, që më parë kishin votuar për AKP-në.

Në zgjedhjet e fundit, AKP-ja ishte në gjendje të fitonte vetëm 4 nga 39 vende të caktuara për krahinat kurde, ndërsa pjesa tjetër shkoi ekskluzivisht për HDP-në. Axhenda politike liberale e Demirtash, tërhoqi gjithashtu disa nga "votat e protestës", kundër rritjes së autoritarizmit të Erdoganit, veçanërisht në pjesën

perëndimore të Turqisë.

Jo vetëm që HDP e kaloi pragun, por kjo parti fitoi ndërkohë 80 vende në parlament, dhe është tanimë një forcë kyçe në bllokimin e aspiratave të Erdoganit, për t'u shndërruar në një lider të gjithë-pushtetshëm të Turqisë.

Çfarë do të ndodhë me AKP-në?

Shumë vetë i kanë interpretuar rezultatet e zgjedhjeve të qershorit, si një dëshmi se votuesit donin një kalim tek një epokë post- Erdoganit: Në fund të fundit, nevoja për të formuar një qeveri koalicioni, ishte e sigurtë në frenimin e ambicjeve të Erdoganit.

Megjithatë kjo atmosferë optimiste, nuk zgjati për shumë kohë. Erdogan blloko krijimin e një koalicioni të tillë, dhe bëri thirrje për zgjedhje të reja në muajin nëntor, teksa dhuna në vend filloi të përshkallëzohet. Që atëherë, ai ka bazuar strategjinë e tij mbi supozimin, se shpërthimi i dhunës do të tubojë votat e nacionaliste dhe konservatorëve rreth AKP-së. Ai e ka përforcuar këtë strategji, duke e portretizuar HDP-në dhe Demirtashin si aleatë të PKK-së, dhe kështu si përgjegjës të destabilitetit aktual. Gjithësesi, sondazhet sugjerojnë se AKP sërish nuk do të mund të sigurojë një shumicë solide në parlament – çka do ta lërë vendin pa një qeveri të forte, që do mund t'i jepte fund ciklit të dhunës.

Disa analistë parashikojnë se Erdogani i etur për pushtet, mund të kërkojë “rivotim” pas “rovitimi”; këtë herë, ai mund edhe të përdorë dhunën në disa zona të populluara në shumicë nga kurdët, si një justifikim për të mos për të zhvilluar fare zgjedhje aty, pasi në të kundërt shumë vota do të shkonin në favor të HDP-së. Pavarësisht këndit të analizës, Turqia duket e destinuar për më shumë paqëndrueshmëri. Kjo është e sigurtë, përveçse rastit kur Erdoganit të vendosë të rishqyrtojë strategjinë e tij dhe ta rrikthejë AKP-në tek rrënjët e saj reformiste, demokratike dhe gjithëpërfshirëse. Kjo ishte Turqia, me të cilin presidenti amerikan Barak Obama aspironte që kishte një “partneritet” model.

Dështimi për të ringjallur atë axhendë, ka gjasa të përkeqësojë kaosin në Turqi, duke rrezikuar mundësinë e asaj që disa e kanë quajtur “sirianizimi” i Turqisë.

Nëse kjo ndodh, sfidat aktuale me të cilat përballen aktualisht Shtetet e Bashkuara në rajon, do të bëhen edhe më të frikshme.

Shënim: Kemal Kirishçi është anëtar TUSIAD dhe drejtor i Qendrës për Shtetet e Bashkuara dhe Evropën në Turqi, me një ekspertizë mbi politikën e jashtme turke. Sinan Ekim, është asistent shkencor në këtë qendër.

Brookings Institute



Loja e Putinit në Siri

NGA NOAH FELDMAN

Cila është loja e e vërtetë Vladimir Putinit në Siri? Rusia tanimë ka vendosur një mini-forcë ajrore luftëtarësh, bombarduesish dhe helikopterësh në një aeroport pranë Latakias, ku qëllimi i tij i vetëm i mundshëm është mbështetja e regjimit të presidentit Bashar Al-Asad. Por mbajtja në këmbë e qeverisë së Asadit, dhe zgjatja e luftës civile në Siri, nuk është një qëllim në vetvete për Putinin, i cili natyrisht që do të rrisë praninë e Rusisë në atë rajon.

Ka më shumë të ngjarë që synimi real i presidentit rus, të jetë ndërmjetësimi i një zgjidhje për moçalishten siriane, përmes një formule që përfshin krijimin e një shteti të cunguar sirian, në të cilin pakica alevite do të shndërrohet në një shumicë. E dhënë ndyshe, Putini po e mbështet Asadin, në mënyrë që të mund ta “shesë” atë jashtë.

Lufta civile në Siri

Thuhet shpesh se Putini po përfshihet në konfliktin në Siri, për të shpëputur vëmendjen nga ekspansionizmi i tij i vazhdueshëm në Ukrainë. Por ky shpjegim, mund të jetë shumë më i thjeshtë se ç’duhet. Putini po kërkon të tregtojë diçka

me Perëndimin, në këmbim të së cilit ky i fundit të lejojë vazhdimin e konsolidimit rus në Ukrainë. Emri i lojës nuk është çmenduri – ai quhet sistemi i levave. Duke hedhur sytë rreth e rrotull globit, nuk ka shumë vende ku Rusia mund t'i ofrojnë diçka që Perëndimit i nevojitet. Siria është një vend, ku Rusia mundet potencialisht të ndihmojë SHBA-në dhe Evropën të arrijnë një objektiv të nevojshëm.

Kriza e refugjatëve, e ka shndërruar gradualisht luftën civile në Siri një çështje të brendshme evropiane. Shtetet e Bashkuara kanë një interes serioz për përfundimin e luftës civile, sepse vazhdimi i saj do të krijonte kushte ideale për zgjerimin e Shtetit Islamik. Por as SHBA dhe as Evropa, nuk kanë kapacitetin dhe vullnetin e duhur, për t'i dhënë fund luftës siriane.

Uashingtoni ka përdorur fuqinë ajrore për të luftuar ISIS-in, por fushata e bombardimeve nuk ka arritur të përmbajë plotësisht rritjen e grupit militant sunit. Në çdo kohë, gjatë viteve të fundit, Shtetet e Bashkuara mund të drejtonin bombarduesit kundër Asadit, do të kishin dobësuar seriozisht regjimin e tij, dhe ndoshta presidentin sirian do të ishte rrëzuar nga pushteti.

Por administrata e Barak Obamës ka frikë, dhe jo pa arsye, se rrëzimi i Asadin do të ishte një dhuratë për Shtetin Islamik. Kjo nga ana tjetër thuhet me siguri do të shkaktonte masakrimin e alevitëve, që cilësohen të pafe nga ISIS-i, dhe do të krijonte një valë të re refugjatësh sirianë, të cilët do të niseshin drejt Evropës.

Irani, që ka qenë një përkrahës i madh i Asadit, mundej gjithashtu në çdo moment gjatë viteve të fundit të merrte iniciativën, për t'i dhënë fund luftës duke nxitur presidentin sirian të pranonte krijimin e një shteti të cunguar alevitët në një pjesë të Sirisë.

Por as kjo nuk ka qenë në interesin e Iranit, të paktën siç interpretohet nga lideri suprem Ajatollah Ali Khamenei. Siria e Asadit është ura lidhëse e iranianëve me Hezbollahun, dhe një Siri e kufizuar me sundimtar Asadin, do të kishte më shumë probleme të lidhura me milicinë libaneze në ofrimin e furnizimeve, duke përfshirë edhe raketat.

Nga ana tjetër, Irani ishte përfshirë në negociata të gjata mbi programin e tij bërthamor me SHBA-në, dhe nuk kishte asnjë arsye për të ndihmuar kundërshtarin e tij. Tek e fundit, Siria edhe kështu si është, mbetet një ledh i rëndësishëm mbrojtës për Iranin, kundër shumicës sunite arabe në rajon, dhe Teherani nuk kishte asnjë arsye për të lejuar tkurrjen e mëtejshme të tij. Interesat e Rusisë në Siri janë të ndryshme. Lidhjet dikur ngushta të historike mes Bashkimit Sovjetik dhe bathistëve në Damask, janë dobësuar që prej rënies së komunizmit, qëkurse financimi i dikurshëm rus në Lindjen e Mesme tashmë nuk ekziston. Mbetet gjithësesi një lidhje e mjaftueshme sa për t'i dhënë Putinin idenë e ri-angazhimit me Sirinë. Por Rusia nuk ka ndonjë interes thelbësor strategjik tek Asadi apo Siria. Putini thjesht po përfiton nga rasti. Asadi duhet ta dijë këtë – por ndërkaq ai është i dëshpëruar për të ruajtur ekzistencën e regjimit të tij, siç u tha vetë Putini gazetarëve (mesa duket me një nënqeshje) të hënë gjatë vizitës së kryeministrit izraelit Benjamin Netanjahu. Nëse Putini dëshiron të ofrojë mbështetje ajrore për Asadin, lideri sirian nuk është në pozitën për të thënë jo.

Nga kjo analizë rezulton se Putini po e rrit mbështetjen për Asadin, në mënyrë që të përdorë mundësinë e një paqeje të ndërmjetësuar, si një mjet negocimi në marrëdhëniet e tij të trazuara me Perëndimin. Kjo nga ana tjetër ngre dy pyetje të papërpunuara, por shumë të rëndësishme: A mund t'ia dalë Putini në këtë mision? Dhe nëse po, cili do të ishte çmimi (përfshirë Ukrainën) që ia vlen për SHBA-në dhe Evropën?

Duket thjesht e mundur që Putini, t'i bëjë realisht presion Asadit për të arritur një marrëveshje, që do ta linte atë në pushtet, në krye të një shteti shumë të reduktuar alevit. Zaten, Asadi duhet të kuptojë se nuk e ka ai në dorë fundlojën e luftës civile. Edhe me gjithë ndihmën e Iranit, që mund të jetë i gatshëm t'ia japë,

ai s'mund të presë të jetë i besueshëm, se do të arrijë të rivendosë nën kontroll pjesët e vendit, të cilat i ka humbur.

Në fakt, Perëndimi nuk ka qenë i gatshëm për ta hequr atë qafe, pikërisht nga frika e alternativës. Dhe bombardimet mbi Shtetin Islamik, e kanë ndihmuar atë në mënyrë të tërthortë të qëndrojë në këmbë. Por kjo është shumë larg nga ndihma që Perëndimi mund t'i jepte direkt, duke rënë dakord ta ndihmonte të rimerrte sërish kontrollin në të gjithë vendin e tij.

E vetmja dhe pak e imagjinueshme zgjidhje për luftën civile, është një Siri më e vogël – dhe Asadi mund të arsyetojë se do të jetë më mirë drejtimin e saj, sesa do të ishte në mërgim. Ajo që Asadi do të duhet ta cilësojë si një marrëveshje të tillë, do të jetë garancia konkrete ushtarake e territorit të tij kundër Shtetit Islamik. Rusia mund ta ndërmjetësojë fitimin e një garancie të tillë, dhe të marrë pjesë në të, duke përdorur fuqinë e saj ajrore.

Edhe nëse mund t'ia vlejë, mbetet ende një çështje e vështirë. Duke pranuar de facto një Siri të reduktuar, mund të lërë një Perëndim në luftën vetëm kundër Shtetit Islamik. Në pamje të parë kjo mund të lehtësojë luftën kundër grupit xhihadist. Por nga ana tjetër mund të forcojë ISIS-in, duke i dhënë shpresë për një njohjeje afatgjatë në zonat me shumicë sunite të ish-Sirisë.

Dhe kjo do të nënkuptonte pranimin e agresionit të Putinit në Ukrainë, si pjesë e marrëveshjes, qoftë të negociuar apo jo. Kjo do të konsolidonte Putinin në pozitën e një ekspansionisti të rrezikshëm në arenën ndërkombëtare – por edhe të një virtuozit të politikës së jashtme.

Megjithatë, kostoja njerëzore e luftës civile në Siri është aq e madhe – dhe ende në rritje – sa do të ishte qesharake të hidhej poshtë mundësia e një marrëveshje të ofruar nga Moska. Putini është duke bërë lojën e tij. Tashmë duhet parë se cilat do të jenë lëvizjet e SHBA-së, dhe nëse Obama mund të largohet nga zyra, duke e filluar procesin e ri-vendosjes së një lloji stabiliteti, të paktën në një pjesë të Sirisë.
/ **“Bloomberg View”**



Bashar Al-Asad dhe loja fundore e djallit

NGA DOMINIC TIERNEY

Shteti Islamik po vret dhe skllavëron mijëra njerëz në Siri dhe Irak. Rusia ka dërguar dhjetëra avionë, për të mbështetur regjimin e Damaskut. Turmat njerëzish kanë mësyre në Evropë. Në syrin e ciklonit, Bashar Al-Asadi po ndjek një strategji cinike, brutale, dhe të rrezikshme për të qëndruar në pushtet. Mesa duket, plani i tij ka për synim të ndihmojë rritjen e ISIS-it, në zbatim të asaj taktike që unë e quaj loja e djallit. Logjika është e thjeshtë dhe i pamëshirshme: radikalizimi i opozitës në atë nivel, që diktatori sirian të ngjajë si e keqa më e vogël para publikut vendas dhe të huaj.

Në këtë rast, Asadi përfiton nga natyra në thelb polarizuese e luftës civile, si një cikël vrasjesh dhe hakmarrjesh që i shtyn të gjitha palët në ekstreme. Presidenti sirian ka nxitur më tej radikalizmin, duke i përqendruar sulmet e tij ushtarake mbi armiqtë e moderuar, ndërsa thuhet se ka liruar xhihadistët nga burgu dhe po ble naftë nga ISIS-i.

Gjatë muajve të fundit, ushtria siriane dyshohet se po i përdor sulmet ajrore për të ndihmuar avancimin e ISIS-it drejt qytetit të Alepos. Khaled Khoja, një udhëheqës i opozitës siriane, deklaroi se avionët luftarakë Asadit janë duke vepruar si “një forcë ajrore për ISIS-in”. Me shtimin e fraksioneve, qendra s’mund të

rezistojë. Në vitin 2011, ushtria relativisht e moderuar për Sirinë e Lirë, dukej një kandidat e besueshme për të udhëhequr rezistencën kundër Asadit.

Tani fraksionet kryesore rebele përfshijnë ISIS-in, Frontin Islamik dhe Frontin Al-Nusra, që është i lidhur me Al-Kaedën. Përpjekja e Shteteve të Bashkuara për të trajnuar një forcë të moderuar siriane, është dëshmuar si një pretendim i mjerë dhe donkishotesk. Pas 10 muajsh dhe miliona dollarëve të harxhuar, SHBA-ja krijoi një ushtri rebele me 5 të fortë. Jo 5.000 të fortë, apo 5 përqind të opozitës. Por fjalë për fjalë, për 5 djem që ishin përgatitur në mënyrë të mjaftueshme për të drejtuar një operacion ushtarak.

Tirani dhe terroristët kanë një marrëdhënie simbiotike. Ndërsa ISIS-i është në parim kundër regjimit laik, fokusi i tij është tek ndërtimi e Kalifati, dhe jo të heqë qafe Asadin. Ndërkohë, përparimi i ISIS-it në Irak në vitin 2014, ishte një dhuratë nga Perëndia për regjimin sirian.

Kryengritësit u larguan nga Damasku. Ndërsa pushtimi nga ana e xhihadistëve i qytetit të Mosulit, dhe pjesës dërrmuese të provincës së Anbarit, e tmerroi Perëndimin. Një Barak Obama hezitues, s'mund të pranonte rënien e Bagdadit, ndaj dhe autorizoi sulme të gjera ajrore kundër ISIS-it.

Si për vendet perëndimore, ashtu edhe për alevitet e Asadit në Siri, zgjedhja është e zymtë: mes djallit që e njohim apo një grupi demonësh grabitqare. Nëse Asadi rrëzohet, përfituesit kryesorë do të jenë forcat e shumta islamike, të cilat po i bombardon aktualisht SHBA-ja. Nëse duhet të rikujtohen rreziqet që vijnë nga rrëzimi i një diktatori, zyrtarët amerikanë duhet vetëm të shikojnë se ç'ndodhi në Libi, ku përmbysja e Muamar Gedaftit në vitin 2011 çoi në anarki.

Asadi është kandidati i destinuar: Nuk ka alternativë. Atëherë, lëvizja e parë djallit, duket se ka pasur sukses. Administrata Obama ka hequr dorë kohët e fundit nga insistimi, se Asadi duhet të largohet nga pushteti, ndërsa ka sinjalizuar se diktatori mund të qëndrojë në pushtet për një periudhë kalimtare, si pjesë e një marrëveshjeje paqeje.

Por fjala kyçe këtu është "duket". Ngjashëm me paktin mes nazistëve dhe sovjetikëve në vitin 1939, partnerët në "vallen" siriane të vdekjes do të therin njëri-tjetrin në momentin më të përshtatshëm.

Mesa shihet fundloja e Asadit, synon të spastrojë fushën nga cilido grup relativisht i moderuar, rreth të cilit sirianët dhe komuniteti ndërkombëtar mund të bëhen bashkë, dhe ndërtojnë më pas një koalicion për të mposhtur ISIS-in. Ai do të trashëgojë një djerrinë shkretinore, por mbetet gjithësesi një trashëgimi.

Megjithatë në përpjekje drejt këtij qëllimi, Asadi po përballet me një problem serioz.

Lëvizja e tij e fundit, mund të ketë funksionuar në kryeqytetet perëndimore, por ai po humb shumë forca në vend. Regjimi ka pësuar një sërë humbesh që e kanë detyruar të tërhiqet pas, duke humbur mijëra ushtarë dhe duke u prapsuar sërish në vende strategjike si Damasku. Sipas një llogaritjeje, Asadi aktualisht kontrollon vetëm rreth një të pestën e Sirisë: një rrip të ngushtë territori përgjatë skajit perëndimor të vendit.

Pozicioni i përkeqësuar i presidentit sirian, ka bërë që padronia e tij fuqimadhe, Rusia, të shtrojë pyetjen nëse diktatori vijon që të mbetet ende një bast afatgjatë. Kremli ka lëvizur asete të rëndësishme ushtarake, për të ndihmuar regjimin e Asadit dhe të dielën e shkuar njoftoi për nënshkrimin e një marrëveshjeje me Sirinë, Iranin, Irakun dhe për të ndarë informacionet e shërbimeve inteligjente në luftën kundër ISIS.

Vetëm disa ditë më parë, Vladimir Putini tha: "Qëllimi ynë kryesor është të mbrojmë shtetin sirian". Por, vini re: ai nuk tha se do të mbrojë personalisht Asadin. Tek e fundit, diktatori sirian është thjesht një mjet drejt një qëllimi: mbrojtja e interesave të Moskës në vend dhe në rajon, duke përfshirë bazën e saj detare në Tartus, struktura e vetme ushtarake ruse jashtë ish-Bashkimit Sovjetik.

Sikurse komentoi në gusht Fjodor Lukjanov, këshilltar i politikës së jashtme të Kremlinit “Rusia ende beson se Asadi duhet të qëndrojë në pushtet, por nuk mund të injorojë faktin se situata e përgjithshme po ndryshon, dhe se pozita strategjike e Sirisë, është shumë më keq tani se më parë”.

Këto dy dinamika kyçe- radikalizimi i opozitës dhe lufta e ushtrisë siriane – kanë shtyrë Shtetet e Bashkuara dhe Rusinë më pranë një marrëveshje, ku Asadi do të luajë një rol tranzicional, nën një regjim të ri. Qeveria e reformuar siriane do të përbëhet nga opozitarë të moderuar, që më pas në bashkëpunim me Perëndimin dhe lojtarët rajonalë do të drejtojnë zjarrin kundër ekstremistëve islamikë.

Ky rezultat i ngjan shumë fundlojës së preferuar të Asadit: Damasku kundër barbarëve. Çështja kryesore, është nëse vetë Asadi do të qëndrojë në krye. Gjithçka gjitha varet nga përkufizimi i termit “tranzitor” dhe gatishmëria e qeverive ruse dhe iraniane, për të mbështetur maksimalisht Asadin. Si një të mbijetuar i pamëshirshëm, Asadi mund të dashurojë shanset e tij për të qenë përherë një president i përkohshëm. Ai mund të ofrojë edhe dorëheqjen, sapo terrorizmi në Lindjen e Mesme të jetë mposhtur.

Shënim: Donimic Tierney është bashkëpunëtor i “The Atlantic” dhe një profesor i asociuar i shkencave politike në Sëarthmore College. Libri i tij i fundit është “Rruga e duhur për të humbur një luftë: Amerika në epokën e konflikteve të pamundura për t’u fituar

THE ATLANTIC



Piketi: Eurozona qeveriset si teknokraci, Grexit rrezik ende i madh

Në intervistën e dhënë për “The Conversation”, ekonomisti i njohur francez Tomas Piketi, kritikon vonesat e BE-së në trajtimin e çështjes së lehtësimit të borxhit grek, gjë që sipas tij mban ende në nivele të larta, rrezikun e një dalje të mundshme të Athinës nga eurozona

Fitorja e Aleksis Cipras në Greqi, ishte e papritur për disa. Po çfarë ka ndryshuar realisht për këtë vend?

Normalisht, ne presim pak stabilitet për vitet e ardhshme. Por mbi të gjitha, Greqia dhe Evropa duhet për rifitojnë kohën e humbur. Deri më tani, Evropa ka refuzuar me kokëfortësi të flasë seriozisht, për ristrukturimin e borxhit të Greqisë. Kjo ishte ajo që shkaktoi edhe rënien e qeverisë së fundit.

Evropa la në fakt të kuptohet, se do të rishikonte borxhin sa më shpejt që grekët të arrinin të balanconin buxhetin e tyre, me një tepricë të vogël buxhetore primare, çka do të thoshte se Greqia do të kishte më shumë të ardhura sesa shpenzimet publike. Por kur grekët bënë thirrje për ndihmë në dhjetor të vitit 2014, Evropa u tha “jo”. Në fund të fundit, ky moment hapi rrugën për Aleksis Ciprasin. Dhe situata vazhdoi e njëjtë. Ndërmjet janarit dhe korrikut 2015, Evropa nuk pranoi të rihapë bisedimet. Tani jemi në shtator, dhe pakoja e re e ndihmës që u disku-

tua këtë verë, ka çuar në shtyrjen e mëtejshme të negociatave mbi borxhin. Nëse Evropa këmbëngul për shlyerjen e plotë të detyrimeve, kriza do të rifreskohet dhe problemi s'do të zgjidhet.

Pse dialogu ndërmjet Evropës dhe Greqisë duhet të ndryshojë?

Evropa ka edhe probleme të tjera për të trajtuar. Është kriza e emigrantëve, dhe situata më e gjerë ekonomike. Evropa, Gjermania dhe Franca nuk mund të ekzistojnë në një gjendje të përhershme krize. Evropianët duhet të rregullojnë pozitën e tyre. Dhe që të ndodhë kjo, Franca duhet të jetë më shumë e guximshme - edhe të tjerët gjithashtu. Ndoshta zgjedhjet në Spanjë në fund të këtij viti, do të ndryshojnë disa gjërat. Të gjitha këto elemente mund të kombinohen, për të ndikuar shumicën e politikave në Evropë, kur është fjala për çështjen greke.

Cilat duhet të jenë përparësitë ekonomike të Ciprasit tani e tutje?

Modernizimi i sistemit të taksave, është qartësisht njëri nga prioritetet. Ai duhet të jetë më i drejtë e më efikas. Por kjo mund të realizohet vërtet, vetëm përmes bashkëpunimit me Evropën - dhe nëse kjo e fundit vendos një shembull vetjak. Duhet të kemi parasysh se bizneset më të mëdha në Evropë, shpesh paguajnë më pak taksë sesa bizneset e vogla dhe të mesme. Kjo për shkak se qeveritë bëjnë marrëveshje, që krijojnë kushte më të favorshme për industrinë e tyre kombëtare. Mjafton të përmend faktin se Komisioni Evropian ka një president, i cili si kryeministër i Luksemburgut, ka nënshkruar dikur marrëveshje me korporatat shumëkombëshe, që u lejonte këtyre të fundit të paguanin një tatim fitimi prej vetëm 1-2 përqind.

Evropa thjesht s'mund të japë këshilla, pa kryer vetë një transparencë fiskale. Kjo shkon në zemër të sistemit bankar - bankat gjermane dhe franceze janë tepër të lumtura të menaxhojnë paratë e grekëve të pasur.

Çfarë duhet të bëjë presidenti francez Fransua Holond për Greqinë?

Këtë verë, Fransua Holond, ka filluar të bëjë sugjerime për bërjen e eurozonës më demokratike. Në veçanti, ai ka folur në lidhje me krijimin e një parlamenti të vendeve të eurozonës. Megjithatë mbetet ende i ndrojtur dhe shumë i paqartë. Në qoftë se ai dëshiron të bëjë diçka, për të patur shanse për një mandat të dytë, dhe mbi të gjitha për të përmirësuar qeverisjen e eurozonës, ai duhet të bërë propozime më të sakta.

Unë besoj se do të kishte më pak masa shtrënguese në Greqi, dhe më shumë zgjidhje në rast se do të kishte patur diskutime publike, demokratike në një parlament të eurozonës, të përbërë nga përfaqësues të secilit parlament kombëtar.

Problemi është se eurozona aktualisht qeveriset si një teknokraci. Krerët e shtetit takohen me dyer të mbyllura. Ata miratojnë propozime të pabesueshme në mes të natës, si privatizimi i 50 miliardë eurove asetëve greke, në një kohë që të gjithë e dinë se do të jetë si një shitje në ankand. A thua se ekonomia greke do të mund të shesë aktivet e saj në këto kushte!

Kjo ka ndodhur pa asnjë diskutim ligjor, dhe pa sqaruar motivet që qëndrojnë pas këtij vendimi. Ne kemi nevojë t'i japim fund kësaj Evrope, dhe filluar nga e para me një parlament të eurozonës, që mundëson që motivet e secilit të bëhen publike. E rëndësishme tani, është se Franca, dhe të gjitha vendet që duan të bëjnë progres, duhet të bëjnë propozime të qarta për të ristrukturuar në mënyrë demokratike eurozonën.

A duhet t'i druhemi ende një Grexit?

Po. Rreziku është se me shtyrjen e diskutimeve mbi ristrukturimin e borxhit, ne të shkaktojmë brenda një ose dy vjetësh pamundësinë për t'u respektuar kushtet e paketës së ndihmës. Ne duam Greqia të mbajë një sufiçit të madh buxhetor primar për 20-30 vitet e ardhshme, çka do të thotë lënien mënjane një të buxheti të

madh për pagesat. Por si mund të justifikohet kjo tek të grekët e rinj? Do të ishte e arsyeshme, të thuhet se deri kur ekonomia greke të rimëkëmbet, nevojitet të garantojë një tepëri të reduktuar primare të buxhetit rreth nivelit të PBB-së. Kjo është normale, dhe jo tepër ndëshkuese.

Jam i shqetësuar se disa njerëz vazhdojnë të vënë bast për një Grexit, vendosin objektive që janë të pamundura për të përmbushur, në mënyrë që kur Greqia të dështojë, ajo të mund të shtyhet drejt largimit nga eurozona. Ky skenar është ende një rrezik, dhe kjo është arsyeja pse ne kemi nevojë për qartësi, objektiva realiste dhe shpejtësi në veprime.

The Conversation



Premtime, buzëqeshje, dhe tani sakrifica: Jeta e dytë e Aleksis Ciprasit

Dje, një karikaturë e Kathimerinit, shfaqte Aleksis Ciprasin në një liqen djerse, i ulur në shtrat. “Cfarë makthi”, i thotë të shoqes. “Pashë ëndërr sikur fitova përsëri”. Dje në mbrëmje, ai skenar i është imponuar një Athine çuditërisht të shastisur, si një realitet i padiskutueshëm. Ciprasi ka shpëtuar sërish, do të rikthehet kryeministër. Netët pa gjumë, ato të vërtetat, e presin, atëherë kur do të duhet të përdorë pushtetin e rimarrë për të realizuar një program europian reformash, për të cilin ai betohet se nuk i beson aspak. Për momentin, Kryeministri është i sigurtë në pallatin e tij, Greqia jo. Ndoshta kjo është arsyeja përse dje në Athinë ra ajo heshtje joreale, e vetmja risi e ritit të zgjedhjeve, që për pjesën tjetër shkoi si gjithmonë: Ciprasi synoi gjithçka në ruletën e zgjedhjeve, dhe doli fitues. Dy muaj më parë, mbështetësit e udhëheqësit të ri grek kishin kërcyer deri vonë në sheshin Sintagma, duke festuar triumfin e “Jo”-së në referendumin kundër masave të kursimit, pa e ditur që lideri i tyre do të firmoste në Bruksel një marrëveshje edhe më të vështirë.

Nëntë muaj më parë, sheshet ishin mbushur me flamuj për triumfin e parë të të

majtës radikale në zgjedhjet politike, përpara se çdo pikë e programit me të cilin Ciprasi dhe Syriza u ishin paraqitur zgjedhësve, të hidhej poshtë. Ndërsa dje, mbi kryeqytetin grek rëndonte një heshtje dhe një palëvizshmëri mbytëse: thjeshtë një tjetër mbrëmje të nxehti dhe recesioni, dhe për Syrizan një tjetër rezultat identik me atë të nëntë muajve më parë, mbi bazën e një programi krejt të kundërt.


Nuk ka treguar ende se di të qeverisë Aleksis Ciprasi, por ka kuptuar një sekret të demokracive europiane të këtij shekulli: ndonjëherë, zgjedhësit krijojnë një marrëdhënie personale me udhëheqësit, më shumë se sa një marrëdhënie me programet e tyre. Për aq sa Greqia është një laborator, udhëheqësi i saj është prova e gjallë e këtij realiteti të ri. Ciprasi kishte bërë fushatë për fundin e sakrificave, por tani duhet të menaxhojë rritjen e taksave mbi pasuritë e paluajtshme dhe mbi bizneset, shkurtime të mëdha për të gjithë pensionistët, norma më të larta mbi taksat indirekte dhe rritje të moshës së pensionit. Kishte premtuar rikthimin tek rritja ekonomike, por është paraqitur në zgjedhjet e djeshme në një Greqi më të përrulur se nëntë muaj më parë, me pengesa dhe kontrole bankare, që mendojnë dhjetëra kompani.

Ciprasi ishte angazhuar edhe që të vinte poshtë “oligarkët”, por bashkë me familjen, shkoi për pushime në vilën e një pronari të madh anijesh në Kepin Sunio, duke shkuar përditë me helikopter në zyrën e tij në Athinë. Ishte betuar për luftë kundër korrupsionit, por ministri i tij, mentori dhe besniku Alekos Flabouraris, u përfshi në një skandal me kompaninë e tij të ndërtimit.

Rezultati: pas këtij slalomi kolosal mes fjalve dhe realitetit, Ciprasi ka fituar përsëri. Pothuajse me të njëjtën përqindje si më parë. Falë premtimeve të tij, buzëqeshjeve, por edhe pranimit të “gabimeve”, si dhe duke tundur në ajër një program paralel me atë europian për grekët, ia ka dalë të kapitalizojë sërish me pakënaqësinë e grekëve ndaj të gjithë klasës politike.

Për të, e vështira fillon tani, në këtë jetë të dytë si kryeministër. Ciprasi në fakt ka neutralizuar ndarjen e grupit të majtë të “Bashkimit popullor”, i cili ishte kundër marrëveshjes me Europën, sepse ai mbetet jashtë Parlamentit. Por brenda Syrizas mbijeton një “grup i të 53-ve”, absolutisht i kundërvënë ndaj masave që i nevojiten Greqisë për të mbajtur të hapur linjën e kredive me pjesën tjetër të Europës. Kryeministri do të provojë të kontrollojë shumicën e tij me armën më efektive që ka në dispozicion: rrezikun (e nënkuptuar) për të transformuar deputetët në të papunë, në rast se shkohet në një krizë të re politike. Në Greqinë e sotme, pak kush mund t’i lejojë vetes që të heqë dorë nga një pagë dhe një vend në sallën pranë sheshit Sintagma.

Por pikërisht ashtu si nëntë muaj më parë, Ciprasi do të ketë nevojë për një aleat apo dy, për të garantuar shumicën. Duket e mundshme që do të përpiqet edhe një herë të kërkojë votat që i mungojnë në të djathtë radikale dhe nacionaliste të Greqëve të Pavarur: një forcë absolutisht kundër reformave, deri dy muaj më parë. Me këtë formacion, kryeministri do të përgatitet që të bëjë gjithçka që qeveritë e huaja i imponojnë dhe që ai e kishte refuzuar gjithmonë: privatizime, një administratë gjyqësore e rreptë dhe e pavarur, tregje të hapur dhe jo më të rezervuar vetëm për eksponentët e saloneve të Athinës, një buxhet të ngritur mbi një presion të rëndë fiskal, dhe shkurtime të shpenzimeve. Pa gjithë këto, nuk do të vijnë kurrë huatë nga Europa, bankat nuk do të funksionojnë kurrë normalisht dhe Greqia do të mbetet në agoni, deri në krizën e ardhshme sociale, politike ap financiare. Programin e tij të nëntë muajve më parë, Ciprasi e ka braktisur në mënyrë brutale. Se sa seriozisht do ta marrë programin e jetës së tij të dytë, ndoshta këtë, sot nuk e di as ai vetë. /Corriere della Sera



Kapitalizmi i rrezikuar nga kapitalistët

Ekonomisti Robert Reich, Sekretar në kohën e Klintonit, thotë se monopoli dhe superfuqia e grupeve të mëdhenj kanë dëmtuar frymën origjinale dhe jetësore të iniciativës së lirë. “Duhet të rishpërndahet pasuria menjëherë, që në fazën kur prodhohet”. Teknologjia dhe globalizimi kanë prodhuar ndryshime të mëdha në botën e punës, por pabarazia ekstreme në shpërndarjen e të ardhurave, që po eksperimentojmë tashmë prej shumë vitesh, buron mbi të gjitha nga mënyra e organizimit të tregut. Me justifikimin për të mos u lënë më shumë hapësirë atyre që duan më shumë shtet, koalicioni i interesave, që prej dekadash dominon Amerikën, ka penguar prej vitesh përshtatjen e rregullave me realitetin e ri ekonomik. Dhe pa rregulla efikase për të mbajtur sistemin në një ekuilibër të pranueshëm shoqërisht, kapitalizmi nuk funksionon”.

Që në battutat e para, në diskutimin mbi “Si të shpëtojmë kapitalizmin”, lirbin më të fundit të Robert Reich, ekonomisti i famshëm liberal i Universitetit të Berkeleyt, Sekretar i Punës në kohën e Bill Klintonit, nxjerr duart përpara: “Marr pjesë në shumë debate për tema nga më të ndryshmet, por çdo herë, aty përfun-

dohet: mbrojtja e tregut të lirë nga çdo ndërhyrje të jashtme, jo rregulla të reja. Sikur tregu të ekzistonte në natyrë, e të mos ishte një krijesë e njerëzve”.

Megjithatë, dinamizmin më të lartë që ka SHBA në krahasim me Europën, e kemi shpjeguar shpesh herë edhe me kompleksitetin e normativave në fuqi, si dhe koston e lartë të mirëqenies sociale në BE.

“Një gjë – përgjigjet Reich – janë shtresëzimet burokratike, dhe një gjë tjetër rregullat për të bërë të funksionojë mirë një sistem ekonomik. Norma që ndonjëherë edhe duhet të lehtësohen: për shembull ato që mbrojnë për një kohë shumë të gjatë, apo në mënyrë shumë të gjerë disa patenta, duke u dhënë një avantazh të tepruar shumë grupeve të mëdhenj, që tashmë janë kaq të fuqishëm, sa që kanë forcën t’i kundërvihen çdo ndryshimi: e quajnë çdo korrektim, si një ndryshim të rregullave të tregut të lirë. Gjëra që i hamë prej disa dekadash. Por nuk ka qenë gjithmonë kështu në historinë amerikane. Nga duam ta nisim? Në libër unë citoj Eduard Ryanin, president i Gjykatës së Lartë të Uiskonsinit, i cili në vitin 1873, duke u folur studentëve në shtetin e tij, u tha: “Një ditë do të duhet të pyesim se kush duhet të vendosë: pasuria, apo njeriu? Kush duhet të udhëheqë: paraja, apo intelekti? Dhe detyrat publike kujt duhet t’i shkojnë? Njerëzve të lirë dhe të arsimuar, apo shërbëtorëve feudalë të kapitalit të kompanive”?

Megjithatë, ajo ishte Amerika e egër e baronëve grabitës, manjatë të kushtuar ndaj konkurrencës së pandershme.

“Sigurisht. Pastaj, në fundin e Tetëqindës, erdhi ligji antitrust, Ligji Sherman. Dhe në fillim të shekullit XX, ai që frenoi abuzimet e kapitalistëve të paskrupullt dhe që goditi monopolet ishte një president konservator: Theodore Roosevelt. Një që i sulmonte, ata që i quante “keqbërës me pasuri të madhe”, duke shtuar që, përveç se shtypnin punëtorët, ata vinin në rrezik vetë ekzistencën e shtetit”. Reichi thotë se, pas epokës së progresit dhe rritjes së ekuilibruar të pas Luftës së Dytë, në tridhjetë vitet e fundit kemi përjetuar një shtrembërim: “Deri në vitet Shtatëdhjetë, mirëqenia shpërndahej mes punëtorëve më të përlulur. Më pas erdhi kthesa: sot, pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave, është më e madhja në 80 vitet e fundit”.

Po përse politika nuk arrin më të bëjë korrigjime? Përse lobet e sipërmarrësve janë shumë të fuqishëm? Apo përse manjatët e sotëm, nuk janë më padronët e urryer të uzinave të një herë e një kohe, shumë të dukshëm në botën e tyre të çelikut dhe qymyrit, por “princër të rilindur” të teknologjive digjitale me mekanizma gjeniale, të pakapshëm dhe të padukshëm në një ekonomi gjithnjë e më komplekse?

“Të dy gjërat së bashku: pushteti është zhvendosur drejt elitave ekonomike, për shkak të kompleksitetit teknologjik dhe financiar të ekonomisë. Njerëzit e kanë më të vështirë të kuptojnë. Kompleksiteti nuk shpjegon gjithçka, por u mundëson koalicionëve të mëdha të interesave që të akumulojnë paratë, me anë të të cilave fshehin mënyrën me të cilën po shtyjnë ekonominë, në një drejtim që është i favorshëm për ta. Bëjnë lojën e tyre, por e bëjnë duke dobësuar sistematikisht politikën dhe autoritetin e atyre që hartojnë rregullat”.

Që nga industritë farmaceutike që paguajnë kompanitë e ilaçeve gjenetike, që të mos hedhin në treg produktet e tyre me kosto të ulët, e deri tek monopoli agro-industrial, e deri tek abuzimet e kompanive që shpërndajnë ndërlidhjen me shpejtësi të lartë, apo tek tregu i plazmuar i Amazon, në librin e Reich rrëfohen shumë raste të diskutueshëm, apo edhe histori të vërtetë “horrori” të kapitalizmit të SHBA.

Por në fund, ai që ndryshon tregun, që zhdok miliona vende pune, është mbi të gjitha evolucioni i teknologjisë. Vetë Reich në të kaluarën kishte parashikuar një rënie drastike të punësimit në shumë sektorë, dhe në libër rrëfen për një mik të tijin, i cili nga shtëpia e tij në Tucson projektton, prodhon (me një printer 3D) dhe shet (në internet) një makinë në gjendje që të zbulojë disa elementë ndotës në

ajër. Të gjitha këto, i vetëm.

“Është e vërtetë, janë ndryshime radikalë. Por në të njëjtën kohë, mendoj se në vlerësimin e vështirësive tona sot, në SHBA dhe në Europë, po i japim një peshë të ekzagjeruar impaktit të globalizimit dhe teknologjisë, ndërkohë që nënvlerësojmë ndikimin e politikës. Problemet që duhet të përballim, në Uashington, ashtu sikurse në Romë, kanë më shumë të bëjnë me vendimet politike, se sa me ekonominë. Jetojmë në shoqëri shumë të pasura: hapësirat për të korrigjuar drejtimin janë ende shumë të mëdha. Por nuk i përdorim. Problemi është që, ndërkohë që pushteti ekonomik përqëndrohet në majë të piramidës, e njëjta gjë ndodh me pushtetin politik. Dhe kështu nisim thirrjet “larg duart nga tregu i lirë”. Edhe atëherë kur bëhet fjalë thjeshtë për eliminim të monopoleve të reja, apo shmangur përqëndrimin e tepruar në ekonominë digjitale”.

Rritet edhe një ekonomi pjesërisht alternative ndaj asaj të grupeve të mëdha tradicionale: shërbimet “on demand” që ofrojnë shumë kompani rishtare për klientët që i kërkojnë përmes celularëve dhe aplikacioneve. Shërbime të ofruara nga personel që punon me kërkesë, pa raporte të qëndrueshme. Reich e kritikon edhe këtë model. Pasiguria, thotë ai, do të reduktonte aftësinë për të mësuar.

“Po, parregullsia e tepruar në oraret e punës mund të shkaktojë probleme të rëndë. Stresi, pamundësia për të programuar jetën tënde: sistemimin e burimeve për të ngritur shtëpi, martuar, krijuar familje, përgatitur për pension. Por pasiguria mund të reduktojë edhe aftësinë për të mësuar. Nuk flas në libër: në një artikull që kam shkruajtur në vigjilje të Ditës së Punës, kam cituar të dhënat e një studimi të The Economic Policy Institute. Puna në mënyrë rastësore, ndonjëherë me turne të gjatë apo natën, në terma kohëgjatë redukton aftësitë konjitive të punëtorit dhe të fëmijëve të tij”. Cilat janë terapitë e mundshme? Disa prej masave të propozuara në libër, ose janë ndërhyrje shumë të kushtueshme që diskutohen prej vitesh, por duken të vështira për t’u zbatuar, si për shembull futja e një page minimale universale, ose janë risi që mbeten për t’u “shpikur” edhe në planin juridik dhe financiar, si ndarja e fitimeve dhe e të drejtave teknologjike. “Duhet të lindë, dhe shpresoj të lindë nga vetëdijësimi në rritje i njerëzve, një lëvizje masive për krijimin e një sistemi të ri kundërpeshe në interes të atyre qytetarëve, që janë shumica, të cilët nuk kanë ndarë fitimet e ekonomisë në dekadat e fundit. Nuk mund të shkohet më tej në shtrydhjen e klasës së mesme. Mënyrat mund të jenë të ndryshme. Mund të taksohet pasuria e të paktëve, por rrezikohet të krijohet një operacion statik i rishpërndarjes së mirëqenies ekzistuese, në vend që të promovohet krijimi i pasurisë së re. Një qasje më e arsyeshme, mund të jetë ajo e ndarjes në mënyrë më të gjerë e pasurisë në të ardhmen, me masa, si shpërndarja tek çdo qytetar, i një kuote të caktuar të përfitimeve ekonomike që prodhohen prej atyre markave”. Alarmet për pasojat e rënda, edhe politike, të fundit të klasës së mesme lëshohen prej të paktën dhjetë vitesh: nuk ka ndodhur asgjë. Reich, që ka punuar me Bill Clintonin dhe njeh mirë familjen, mendon se Hillary mundet dhe do të donte të ndryshonte rrugë. “Politika e vetme nuk mundet: duhet një ndër-gjegjësim dhe një nismë e kompanive. Puna nuk është që t’ua heqësh të pasurve, për t’ua dhënë të varfërve me taksa, por të miratohen rregulla që të shpien drejt një shpërndarje më të barabartë që në fazën e prodhimit të pasurisë, në vend që të rishpërndahet a posteriori. E komplikuar? Po. Por thelbësore, sepse në kushtet aktuale, një shoqëri nuk mund të zgjasë. Nuk është një sfidë për teknologjinë apo ekonominë: është një sfidë për demokracinë”.

La Lettura



Lamtumirë epokë pa mure dhe gardhe!

NGA BRET STEPHENS

Kjo e sotmja, është dashur të ishte epoka e mungesës së gardheve. Asnjë mur mes blloqeve. Pa kufij mes vendeve. Kurrëfarë pengesa mbi tregtinë. Pa viza për të shëtitur si turist. Një treg i përbashkët. Një internet global. Transaksione pa mosmarrëveshje, dhe shkëmbime pa kufizime. Me pak fjalë, një botë e sheshtë. Po çfarë ndodhi me të?

Në fillim të viteve 1990, Ministri i atëhershëm i Jashtëm i Izraelit Shimon Perez, botoi një libër të titulluar “Lindja e Mesme e Re”, në të cilin ai parashikonte se çfarë do të ndodhte së shpejti në dyqanet e vendeve fqinje. “Tregjet rajonale të përbashkëta do të pasqyrojnë Zeitgeist-in e ri”- nënvizonte ai. Ishte vetëm një çështje kohe, para se kjo të bëhej e vërtetë edhe për pjesën e tij të botës.

E kam lexuar atë libër kur isha në kolegji, dhe ndërsa më mbërtheu krejtësisht si një i jashtëm, ajo ide nuk dukej krejtësisht e çmendur. Dekada nga viti 1989 dhe deri në 1999, ishte një epokë e mrekullive politike, ekonomike, sociale dhe teknologjike. Ra Muri i Berlinit. Bashkimi Sovjetik u shpërbë. Aparteidi përfundoi. Lindi Euro. U prezantua browser-i i parë në internet, çmimi i naftës ra nën 10 dollarë për fuçi, Dow Jones u rrit me 10.000 pikë, Times Square në Nju Jork u bë sërish i sigurtë. Amerika fitoi luftën në Kosovë, pa humbur një ushtar të vetëm në lufti-

me. A do u shesin sërish së afërmi biznesmenë izraelitë, hurma dhe pite të një cilësie tashmë të njohur, konsumatorëve në Damask? E pra, pse jo? I kundërvini kësaj utopie të premtuar, skenat e eksodit bilbik të dhjetëra-mijëra emigrantëve nga Lindja e Mesme, duke marshuar nëpër rrugët dhe hekurudhat e Evropës, kryesisht drejt tokës së tyre të premtuar gjermane.

Imazhet ngjajnë me një version të shekullit XXI- të të Völkerëänderung, emigrimit të popujve në fund të periudhës mesjetare romake dhe të hershme. Njerëzit e dëshpëruar, kishin nevojë për të shkuar në ndonjë vend, duke krijuar gjerësisht peizazhin e një përmbytjeje masive.

Si ndodhi kjo? Ne e ngatërrojmë festën e një historie, me fundin e saj. Ne kemi ndërtuar një botë pa gardhe, bazuar tek një grup supozimesh të gabuara rreth së ardhmes. Ne kërkuam një rend të ri liberal- një me shumë liberalizëm, por pa shumë rregull. Në deshëm një qytetërim bujar, pa bërë gjërat e nevojshme që ai të jetë edhe i begatë.

Në vitin 2003, teoricieni politik Robert Kagan shkroi një libër që të zhyt në mendime, “Mbi Parajsën dhe Pushtetin”, në të cilën ai mori shkas nga ndarja filozofike që ekziston mes amerikanëve dhe evropianëve. Amerikanët, shkroi ai, banojnë në botën e Tomas Hobsit, në të cilën “siguria e vërtetë dhe mbrojtja e promovimi i një rendi liberal, varet ende nga zotërimi dhe përdorimi i fuqisë ushtarake”.

Nga ana tjetër, evropianët, kanë jetuar në botën e Emanuel Kantit, në të cilën “paqja e përhershme” është e garantuar nga një sërë marrëveshesh kulturore, mbi rregullat e të cilave është rënë dakord konsensualisht, dhe besimi tek virtytet e solidaritetit shoqëror, që mbikëqyren nga një shtet që rishpërndarë pasurinë”.

Këto dallime nuk kishin shumë rëndësi, për aq kohë sa kufizoheshin tek diskutimet në panelin e Forumit të Davosit. Pastaj erdhi presidenca e Barak Obamës, e cila adoptoi pikëpamjen kantiane. Për shtatë vjet, SHBA-ja dhe Evropa kanë qenë në një masë të madhe në të njëjtën anë-evropiane për pjesën dërrmuese të çështjeve kryesore, veçanërisht në Lindjen e Mesme: largimi nga Iraku, tërheqja nga Afganistani, ndërhyrja minimale në Libi, qëndrimi jashtë konfliktit sirian, dhe arritja e një marrëveshje mbi programin bërthamor të Iranit.

Rezultati është se kaosi global, ka lëshuar kudo metastazat e veta. Dhe gjendja ka të ngjarë vetëm të përkeqësohet. Bujaria që gjermanët kanë treguar ndaj valës së parë të refugjatëve, është një haraç që vendi ndjen se i detyrohet njerëzimit dhe historisë. Por ashtu si mirëseardhja e ngrohtë, është e destinuar të shndërrohet në një magnet të papërmbajtshëm për emigrantët e ardhshëm, çka do të shkaktojë detyrimisht edhe në një reagim të ashpër në mesin e gjermanëve.

Deri në fund të këtij viti, Gjermania pret deri në 800 mijë emigrantë, ose rreth 1 për qind e popullsisë së vendit. Berlino dëshiron një sistem për shpërndarjen me kuota të barrës së emigracionit tek të gjitha vendet e BE-së, por pasi emigrantët mbërrijnë në Evropë, ata janë të lirë të shkojnë kudo ku mundësitë për punësim janë më të mëdha.

Rezultati është se kaosi global, ka lëshuar kudo metastazat e veta. Dhe gjendja ka të ngjarë vetëm të përkeqësohet. Bujaria që gjermanët kanë treguar ndaj valës së parë të refugjatëve, është një haraç që vendi ndjen se i detyrohet njerëzimit dhe historisë. Por ashtu si mirëseardhja e ngrohtë, është e destinuar të shndërrohet në një magnet të papërmbajtshëm për emigrantët e ardhshëm, çka do të shkaktojë detyrimisht edhe në një reagim të ashpër në mesin e gjermanëve

Gjermania (me 4.7 përqind papunësi), do të jetë me siguri më tërheqëse Franca (me një papunësi prej 10.4 përqind), për të mos folur për Italinë (me 12 përqind) apo Spanjën (me 22 përqind). Nëse Gjermania do të kishte një rritje të fuqishme ekonomike dhe demografike, ajo mund të absorbonte dhe asimilonte lehtësisht këtë fluks.

Por rritja është e vogël, kështu që ajo nuk mund ta përballojë e vetme. Rritja ekonomike ka qenë mesatarisht 0.31 përqind në vit që nga viti 1991. Vendi ka normën më të ulët të lindjeve në botë. Gjermania moderne e tolerante, tani duket se ka një përbuzje të justifikuar përkundrejt nacionalizmit të trashë, zhvendosjes së barrës dhe ndërtimin e gardhit nga qeveria populiste hungareze e Viktor Orban. Por do të ishte qesharake të mendohet për Hungarinë si një reminishencë e së kaluarës, sesa si një paralajmërim. Nuk ka asnjë mësim nga e kaluara që njerëzit nuk do të injorojnë, për hir të lehtësive që servir e tashmja. A ka një mënyrë për të dalë nga ky qerthull? Papritmas, ka një diskutim në Evropë mbi përdorimin e fuqisë ushtarake për të krijuar zona të sigurta në Siri, që të mund të përmbajnë eksodin e refugjatëve.

Nëse administrata amerikane vendos të adaptojë sërish qasjen kantiane, Evropa, madje edhe Gjermania, nuk do të kenë zgjedhje tjetër veçse të rilidhin veten me filozofinë e Hobsit, duke rindërtuar ushtrinë e tyre dhe përdorur fuqinë e ashpër kundër fqinjëve të pamenaxhueshëm. Evropianët nuk do ta përqafojnë lehtësisht këtë opsion. Alternativa është që të shpejtojnë kthimin në epokën e rrethojave. Singëriteti, është një virtyt i blerë përmes forcës.

“Wall Street Journal”



Përse nuk janë zbutur zemrat e Europës Lindore

Ivan Krastev

Duke komentuar mbi prurjen e imigrantëve dhe rrugën që ata përshkojnë nëpër Hungari, drejt Austrisë dhe Gjermanisë, një gazetar hungarez më tha kohët e fundit: “Ne nuk kemi më qytete. Vetëm një stacion hekurudhor të zgjeruar”.

20 vjet më parë, Hungaria dhe fqinjët e saj në Europën Lindore ishin shoqëri post-komuniste në tranzicion, dhe shumë prej tyre - Bullgaria, Maqedonia, Serbia - janë ende të tilla. Tani, brenda natës, këta vende në tranzicion, janë shndërruar në vende tranziti. Si rezultat, bashkë me prurjen e qindra-mijëra imigrantëve, Europa duhet të shqetësohet edhe për “pykën” që kjo krizë po vendos mes gjysmës së saj lindore dhe gjysmës perëndimore.

“Kamioni i turpit” në Austri dhe skenat e imigrantëve të mbytur kanë nxitur një

valë dhembshurie në shumë vende të Europës Perëndimore. Në Gjermani, 60 % e publikut mbështet strehimin nga qeveria të pothuaj 800 mijë refugjatëve, afërsisht sa 1 përqind e popullsisë së vendit.

Megjithatë në Europën Lindore publiku mbeti i pa prekur, dhe udhëheqësit atje kanë qortuar vendimin e Brukselit për të rishpërndarë refugjatët mes shteteve anëtare të Bashkimit European. Shumicat në vendet në tranzicion mbështesin ndërtimin e mureve në kufijtë e tyre; një sondazh i kohëve të fundit në Republikën Çeke tregon se 44% e tyre këmbëngulin që qeveria të mos shpenzojë as edhe një koronë shtesë, për të ndihmuar imigrantët.

Kryeministri i Sllovakisë, Robert Fico, shkoi edhe më tej, duke deklaruar se 95% e strehimkërkesve nuk janë aspak refugjatë, por imigrantë ekonomikë, dhe se vendi i tij do të ishte i përgatitur për të pritur vetëm të krishterë. Më tronditës ishte një email i bërë publik, në të cilin rrjeti kombëtar televiziv hungarez, u kërkonte gazetarëve që të shmangnin transmetimin e pamjeve të fëmijëve të imigrantëve. Me sa duket, qeveria e Hungarisë druhet se pamjet e fëmijëve që vuajnë, do të zbusin zemrat e popullit të vet, dhe do të sjellin, larg qoftë, dhembshurinë.

Cfarë ka ndodhur me Europën Lindore? Vetëm tre dekada më parë, "Solidariteti" ishte simboli i saj. Sot, një simbol më i përshtatshëm do të ishte një afishe ku shkruhet: "Europa Lindore: Atje ku Donald Trumpi është i respektuar". Përgjigja e shkurtër është zhgënjimi, mosbesimi, demografia dhe demokracia.

Pas komunizmit dhe reformave liberale, erdhi cinizmi depërtues. Të përballur me një prurje imigrantësh dhe të përndjekur prej pasigurisë ekonomike, shumë evropiano lindorë ndihen të tradhëtuar nga shpresa e tyre, se hyrja në Bashkimin European do të shënonte fillimin e begatisë dhe fundin e krizës, ndërkohë që shumë udhëheqës të qeverive druhën se e vetmja mënyrë për të siguruar mbështetje politike, është që të tregosh se kujdesesh shumë për të tutë, dhe aspak për të huajt.

Europiano lindorët besojnë se janë ata që kanë nevojë të ndihmohen, se kjo ishte pjesë e premtimit të bashkimit. Si mund të presësh solidaritet nga ne, thonë ata, kur ne jemi më të varfër se sa evropiano perëndimorët? Ne na ishin premtuar turistë, jo refugjatë.

Por nuk është vetëm çështje mëshire për veten. Pavarësisht se jetojnë në kryqëzimin mes Europës dhe Azisë, Rusisë dhe Lindjes së Mesme, shumë evropiano lindorë janë të pavëmendshëm dhe të izoluar. Televizioni bullgar nuk pati asnjëherë as fondet, por as interesin, që të dërgonte gazetarë në vende si Siria, një lëvizje që me siguri do të kishte ndërgjegjësuar njerëzit në vend për dimensionet apokaliptike të asaj që po ndodh atje. Afrika është tërësisht e munguar në gjeografinë tonë politike.

Si rezultat, frika nga Islami, terrorizmi, rritja e kriminalitetit dhe një ankth i përgjithshëm nga e panjohura, janë në qendër të panikut moral që ka provokuar prurja e imigrantëve.

Eshtë e çuditshme, por paniku prej demografisë është një prej faktorëve më pak të diskutuar, që ndikon në sjelljen e evropiano lindorëve. Por është një faktor kritik. Sipas projeksioneve të OKB-së, popullsia e Bullgarisë pritet të tkurret me 27% deri në vitin 2050. Alarmi i "zhdukjes etnike" mund të ndihet në shumë prej kombeve të vegjël të Europës Lindore.

Për ta, ardhja e imigrantëve sinjalizon daljen e tyre nga historia, dhe argumenti i përhapur se Europa ka nevojë për imigrantë, vetëm sa e shton këtë ndjesi në rritje të melankolisë ekzistenciale. Kur sheh në televizion, skenat e të moshuarve që protestojnë për vendosjen e refugjatëve në fshatrat e tyre të shpopulluar ku në dekadat e fundit nuk ka lindur asnjë fëmijë, të thyhet zemra për të dy palët - për refugjatët, por edhe për të moshuarit e vetmuar, që kanë parë botën e tyre të shkrihet.

Integrimi i dështuar i romëve kontribuon gjithashtu për këtë mungesë dhembsh-

hurie. Europiano lindorët kanë frikë nga të huajt, sepse ata nuk kanë besim tek aftësia e shtetit për të integruar “të tjerët” që i kanë tashmë mes tyre. Dhe fakti që shtetet europiano lindore janë demokraci, nuk e lehtëson situatën. Ajo që po shohim nuk është një mungesë solidariteti; ajo që shohim është një përplasje solidaritetesh: solidariteti kombëtar, etnik, dhe fetar që vihen përballë detyrimeve tona si qenie njerëzore. Është bërë e qartë se kriza e imigrantëve është më kërcënuese ekzistencialisht, ndaj Bashkimit European, se sa kriza e Euros apo aneksimi i Krimesë nga Rusia. Donald Tusk, presidenti i Këshillit European, paralajmëron haptas ndaj rrezikut të ndarjes mes Europës Perëndimore dhe asaj Lindore. Thënë kjo, dhembshuria nuk mjafton për të zgjidhur problemet e migrimit në Europë. Disa vjet më parë, filozofi hungarez dhe ish disidenti Gaspar Miklos Tamas vërejti se Iluminimi, ku i ka intelektualisht rrënjët iseja e Bashkimit European, kërkon “nënshtetësi” universale. Por nënshtetësia universale kërkon që të ndodhin një apo dy gjëra: Ose vendet e varfër dhe jofunksionues të bëhen vende ku ia vlen të bëhesh nënshtetas, ose që Europa t’ua hapë kufijtë e saj të gjithëve. Është e qartë se asnjë prej këtyre dy gjërave nuk do të ndodhë. Ndërtimi i një Statuje të Lirisë në Lampeduza, zor se do të mjaftojë për të përballur problemin. Libia dhe Siria janë shembuj shqetësues: As ndërhyrja e europianëve në Libi, as mosndërhyrja e tyre në Siri, nuk kanë qenë në gjendje të ndalin luftërat në fqinjësinë e Europës. E zënë mes detyrimit të saj moral për të ndihmuar të tjerët që janë në nevojë të skajshme, dhe pamundësisë praktike për të ndihmuar çdokënd, Europa do të detyrohet të presë disa, dhe të dëbojë disa të tjerë. Është tejet e trishtë të shohësh shoqëritë dhe qeveritë europiano lindore, të pretendojnë se është moralisht e drejtë që t’ua mbyllin derën atyre që i largohen vdekjes. Mungesa e dhembshurisë nxjerr në pah një krizë më të thellë në zemër të projektit european.

* Ivan Krastev është Kryetar i Qendrës për Strategji Liberale në Sofje, Bullgari si dhe anëtar i përhershëm i Institutit të Shkencave Humane në Vienë